



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

RAPORTI VJETOR

2023

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Tiranë, më 25.04.2024

Miratuar me vendimin Nr.60, datë 25.04.2023 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë

Fjala e Kryetarit

E nderuar Zonja Kryetare,

Të nderuar deputetë të Kuvendit,

Ky raport që po përcjellim përpara Kuvendit ka një rëndësi të veçantë dhe mban një peshë të rëndësishme, duke qenë se përmbyll pesë vitet e para të konstituimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, vite të cilat kanë sjellë risi në zhvillimin e karrierës së prokurorëve, të garantuara në Kushtetutë dhe në ligjet e posaçme.

Me përfundimin e ciklit pesë vjeçar të Këshillit, përgjegjësia për të arritur rezultate të prekshme, konkrete dhe të një niveli të lartë, vjen pa diskutim duke u rritur. Nëse në vitet e para të konstituimit të Këshillit, mungonte përvoja, pasi çdo proces niste për herë të parë, në vitin e pestë të aktivitetit të tij, pjesa më e madhe e proceseve kanë kaluar një sistem të konsoliduar filtrimi dhe qëllimi i Këshillit tashmë nuk është vetëm përmbushja e detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, por përsosja e tyre sipas standardeve evropiane.

Sigurisht, arritja e këtyre qëllimeve nuk është gjithmonë e lehtë, vetëm për shkak të përvojës së përfutur ndër vite, pasi gjatë veprimtarisë së tij, Këshilli është hasur edhe me vështirësi e problematika, të cilat jo detyrimisht lidhen me performancën e tij, por lidhen edhe me çështje teknike, infrastrukturore, apo të burimeve njerëzore.

Viti 2023 për Këshillin ka qenë një vit i suksesshëm, me fokus në mbarëvajtjen e sistemit të prokurorisë, që prej implementimit të Hartës së re Gjyqësore, deri tek plotësimi i vendeve vakante në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, përcaktuar me vendimin Nr.6/2021, të Kuvendit të Shqipërisë.

Gjatë vitit 2023, aktiviteti i Këshillit ka përfshirë një sërë veprimtarish, pjesë e ciklit të karrierës së prokurorëve, prej pranimit të studentëve të profilit prokuror në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, deri në mbarimin e statusit të magjistratëve. Në këto procese, Këshilli ka dhënë shembullin e një institucioni që mbron interesat e prokurorëve dhe mbështet veprimtarinë e tyre të pavarur, duke garantuar një sistem të ndërtuar mbi bazën e meritokracisë.

Bashkëpunimi me institucionet e tjera të qeverisjes së drejtësisë si: Prokurori i Përgjithshëm, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Kuvendi, institucionet qendrore, ka vijuar të jetë në qendër të vëmendjes për Këshillin dhe do të vijojë të intensifikohet, jo vetëm sepse është një detyrim ligjor, por sepse rritja e bashkëpunimit ka treguar ndër vite që sjell gjithashtu rezultate më të larta për të gjitha proceset ku ndërlidhet veprimtaria mes njëri-tjetrit.

Këshilli gjatë këtij viti ka punuar intensivisht për hartimin dhe miratimin e disa akteve nënligjore, duke treguar përpjekjen maksimale për të plotësuar kuadrin

rregullator të përcaktuar në ligjet e posaçme. Tashmë Këshilli ka një analizë të qartë juridike, se ku është ende e nevojshme për të ndërhyrë me akte të rishikuara dhe ku nevojiten akte nënligjore të reja. Sa më sipër, për të mësuar më tepër rreth veprimtarisë së Këshillit për vitin 2023, Ju ftoj të lexoni raportin vjetor.

KRYETAR

Alfred Balla

Lista e akronimeve

KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë.
KLGGJ	Këshilli i Lartë Gjyqësor.
MD	Ministria e Drejtësisë.
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.
KPK	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.
KPA	Kolegji i Posaçëm i Apelit.
ILD	Inspektori i Lartë i Drejtësisë.
SHM	Shkolla e Magjistraturës.
Ligji për Qeverisjen	Ligj Nr.115/2016 <i>“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.</i>
Ligji për Statusin	Ligj Nr.96/2016 <i>“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.</i>
Ligji për Prokurorinë	Ligj Nr.97/2016 <i>“Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.</i>
Ligji për Rivlerësimin	Ligj Nr.84/2016 <i>“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.</i>
Komisioni i Karrierës	Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.
Komisioni i Vlerësimit	Komisioni i Vlerësimit Etik dhe Profesional.
Komisioni i Buxhetit	Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.
SPAK	Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Gjykata e Posaçme

Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin
të Organizuar.

Tabela e përmbajtjes

Fjala e Kryetarit	2
A. Përmbledhje e veprimtarisë së KLP-së gjatë vitit 2023	10
B. Baza ligjore e funksionimit të KLP-së dhe përbërja e tij.....	11
C. Gjendja e burimeve njerëzore dhe projeksioni për tri vitet e ardhshme të sistemit të prokurorisë	13
1. Gjendja e organikave të zyrave të prokurorisë në raport me vakancat faktike	13
2. Të dhëna mbi procesin e rivlerësimit kalimtar të Prokurorëve për vitin 2023.....	16
3. Projeksioni i gjendjes së sistemit të Prokurorisë në lidhje me vakancat, për vitin 2023	17
D. Marrëdhëniet ndërinstitucionale të KLP-së dhe integrimi evropian.....	18
4. KLP-ja dhe marrëdhëniet me institucionet e tjera të drejtësisë.....	18
5. KLP-ja në procesin e integritimit evropian	21
6. KLP-ja dhe Raporti i Progresit	22
7. Kontributi i KLP-së për dokumente strategjike dhe projektakte të sjella për mendim	24
E. Transparenca ndaj publikut dhe mediave.....	26
8. KLP-ja dhe e drejta për informim	26
9. Aktivitetet e KLP-së gjatë vitit 2023 dhe informimi publik	27
a. Nis punën Prokuroria e vetme e Apelit pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë	27
b. Takimi i kreut të KLP-së me përfaqësues të programeve të BE-së në fushën e drejtësisë	28
c. Takimi i kreut të KLP-së, z. Balla me Kryeprokuroren e Kroacisë	28
d. Takimi i Përbashkët Vjetor mes KLP-së dhe KLGJ-së	29
e. Takim me drejtuesen e projektit EU4JUSTICE, zonjën Laura Liguori .	29
f. Intervista e kreut të KLP-së, z. Balla në “BREAKING NEËS”	30
g. Takim i kreut të KLP-së, me Kreun e Inspektoratit të Përgjithshëm të Drejtësisë së Republikës së Francës.....	30
h. Takim me Këshillin e Lartë Prokurorial të Kosovës	31
i. Ceremonia e Betimit të 26 Prokurorëve të rinj, përpara Këshillit të Lartë të Prokurorisë	32
j. Takimi i kreut të KLP-së, me Ministrin e Brendshëm, z. Taulant Balla	32

k.	Takimi i kreut të KLP-së, z. Alfred Balla me Kryetarin e KPK-së, z. Roland Ilia.....	33
l.	Takim me përfaqësuesit e Këshillit të Lartë Gjyqësor të Republikës së Bullgarisë	33
m.	Vizita dy ditore e KLP-së në Këshillin Prokurorial të Republikës të Kosovës.....	34
n.	Kreu i KLP-së pret në takim përfaqësuesit e Misionit Taiex, të Atashuar në Delegacionin e BE-së në Shqipëri.....	35
o.	Takim me Kryetarin dhe përfaqësues të Komisionit të Prokurimit Publik	35
p.	Takim i Reporterëve të Këshillit të Evropës me kreu e KLP-së, z. Alfred Balla	36
q.	Takim me z. Vincent Macq, Ekspert i Projektit CEPEJ dhe përfaqësues të Këshillit të Evropës	36
F.	Veprimtaria administrative dhe proceset gjyqësore	37
10.	Struktura dhe organigrama e KLP-së.....	37
11.	Procesi i rekrutimit të nëpunësve civilë.....	41
12.	Proceset gjyqësore	42
a.	Çështje të juridiksionit fillestar në Gjykatën Administrative të Apelit ..	43
b.	Çështje në Gjykatën e Lartë.....	45
c.	Çështje në KPA dhe në Gjykatën Kushtetuese.....	45
G.	Veprimtaria e komisioneve të përhershme dhe komisioneve të tjera të Këshillit.....	45
	Komisionet e Përhershme	46
13.	Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit	46
a.	Hartimi dhe monitorimi i zbatimit të planit strategjik, në përputhje me objektivat e ligjit për qeverisjen dhe koordinimin me strategjinë e sektorit të drejtësisë.....	46
b.	Mirëorganizimi i fondeve buxhetore për vitin 2023	47
c.	Miratimin e kërkesave buxhetore për vitin 2023-2025.....	48
d.	Aktet nënligjore me karakter financiar në zbatim të Ligjit për Statusin.	50
e.	Miratimi i strukturës organizative të administratës së Këshillit	50
f.	Miratimin e kërkesave për lejimin e veprimtarive jashtë funksionit për prokurorët.....	51

g.	Deklarimi i mbarimit të mandatit të anëtarëve të këshillit për të cilët është plotësuar afati ligjor 5-vjeçar	51
h.	Miratimi i akteve nënligjore.....	52
14.	Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale	53
a.	Vlerësimi etik dhe profesional i prokurorëve	53
b.	Raporte të vlerësimit të aftësive profesionale të prokurorëve	58
c.	Verifikimi i pasurisë dhe figurës për kandidatët për prokurorë të cilët përfunduan formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës në vitin 2023..	60
d.	Verifikimi i pasurisë dhe figurës për kandidatët për pozicion drejtuesi në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm.....	61
15.	Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.....	62
16.	Komisioni i Disiplinor	65
a.	Procedimet dhe hetimet disiplinore ndaj prokurorëve	66
b.	Regjistri disiplinor	66
c.	Aktivitete të tjera të Komisionit të Disiplinës	67
	Komisionet e tjera	67
17.	Veprimtaria e Komisionit për mbrojtjen e prokurorëve	67
H.	Rezoluta e Kuvendit, zbatimi dhe sfidat e KLP-së për vitin 2023.....	68
18.	Niveli i zbatimit të rezolutës së Kuvendit “Për raportin vjetor të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitin 2022”	68
a.	Të përmbyllë plotësimin e vakancave për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe të informojë Kuvendin brenda muajit dhjetor 2023.	68
b.	Të përmbyllë miratimin e akteve nënligjore sipas përcaktimeve në ligjet e reformës së drejtësisë dhe të raportojë në Kuvend për ecurinë brenda muajit dhjetor 2023.	69
c.	Të forcojë bashkëpunimin me Prokurorin e Përgjithshëm në funksion të realizimit të udhëzimeve me karakter të përgjithshëm nga prokurorët e të gjitha niveleve.	70
d.	Të përshpejtojë ritmet e punës në vlerësimin vjetor profesional të prokurorëve dhe të informojë Kuvendin brenda muajit tetor 2023.	71
e.	Në bashkëpunim me KLGJ-në: i. të miratohen rregullat e përbashkëta për bashkimin e procedimeve në rastin kur një gjyqtar dhe një prokuror janë përfshirë në të njëjtën shkelje, si dhe ii. për ngritjen e një sistemi të ri për menaxhimin e integruar të çështjeve.....	73

f. Të ndjekë dhe të konsiderojë me përparësi angazhimet, detyrimet ligjore dhe funksionale që burojnë nga procesi i zbatimit të hartës gjyqësore. 73

g. Të bashkëpunojë me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për hartimin e planit vjetor të inspektimeve tematike, në përputhje me përcaktimet e ligjit Nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, veçanërisht në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut, barazisë para ligjit dhe parimit të proporcionalitetit në proceset penale..... 76

h. Të adresojë çështjet e konstatuara lidhur me aktivitetin e Këshillit në progresraportin e Bashkimit Evropian të vitit 2022..... 77

I. Konkluzione të nxjerra nga veprimtaria e vitit 2023, sfidat dhe prioritetet për vitin 2024 77

19. Konkluzione të nxjerra nga veprimtaria e vitit 2023 77

20. Sfidat dhe Prioritetet e punës së KLP-së për vitin 2024 78

A. PËRMBLEDHJE E VEPRIMTARISË SË KLP-SË GJATË VITIT 2023

Këshilli i Lartë i Prokurorisë gjatë vitit 2023, ka marrë gjithsej 406 vendime, në 32 mbledhje plenare të zhvilluara. Vendimmarrja ka qenë kryesisht e lidhur me akte administrative individuale në funksion të karrierës së prokurorëve. KLP-ja ka pasur gjithashtu në vëmendje dhe ka punuar intensivisht për hartimin dhe miratimin e disa akteve nënligjore, si:

Rregullorja “*Për përcaktimin e rregullave dhe arsyeve të lejimit të kandidatit për magjistrat për t’u emëruar në vitin pasardhës*”;

Rregullorja “*Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë prokurorisë së posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar*”;

Rregullorja “*Për caktimin e rregullave dhe procedurave mbi uljen e ngarkesës së punës për prokurorët*”;

Rregullorja “*Mbi dhënien e lejes së papaguar*”;

Rregullorja “*Për vlerësimin etik dhe profesional të drejtuesve të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm*”;

Rregullorja “*Për caktimin e procedurës dhe masës së trajtimit financiar të prokurorit për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm, për caktimin e përkohshëm dhe caktimin për një çështje të veçantë*”;

Rregullorja “*Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë*”

Sipas parashikimeve të Nenit 167 dhe 178 të Ligjit për Qeverisjen, pranë KLP-së funksionon Sektori i Dokumentimit të Seancave, i cili përgatit dosjet me aktet përkatëse për mbledhjet plenare sipas rendit të ditës, zbardh procesverbalet e mbledhjeve, pasqyron mendimet e anëtarëve të Këshillit, propozimet apo vërejtjet që ata kanë lidhur me diskutimet e tyre gjatë mbledhjes, duke i bërë ato pjesë të procesverbalit, redakton materialet e mbledhjeve në respektim të të drejtave të privatësisë, konfidencialitetit, të dhënave personale apo sensitive në raport me palët e treta, etj.

Mbledhjet plenare të KLP-së edhe përgjatë vitit 2023 janë ndjekur nga përfaqësues të institucioneve dhe organizatave të akredituara pranë KLP-së, si dhe nga programet e asistencës ndërkombëtare për zbatimin e Reformës në Drejtësi, EU4JUSTICE dhe OPDAT.

Mbledhjet Plenare të Këshillit kanë qenë të hapura dhe janë ndjekur sipas interesit nga përfaqësues të medias, shoqërisë civile apo çdo entitet tjetër të interesuar për veprimtarinë e KLP-së. Për mbledhje plenare për të cilat ka pasur interes të

veçantë, është siguruar transmetimi dhe akses online, për të mundësuar përcjelljen e saj në kohë reale.

KLP-ja ka vijuar punën me përgjegjshmëri dhe angazhim maksimal në përmbushjen e detyrimeve të tij kushtetuese dhe ligjore në raport edhe me transparencën ndaj publikut, duke zbatuar të gjitha procedurat e nevojshme për realizimin e mbledhjeve plenare, si njoftimi i rendit të ditës së mbledhjes plenare para zhvillimit të tyre dhe publikimi me transparencë i të gjitha mbledhjeve plenare dhe vendimeve të marra në to, në faqen zyrtare të Këshillit ëëë.klp.al, përfshirë këtu dhe regjistrimin audio të çdo mbledhje.

B. BAZA LIGJORE E FUNKSIONIMIT TË KLP-SË DHE PËRBËRJA E TIJ.

KLP-ja është konstituuar mbi bazën e nenit 149 të Kushtetutës. Detyrat dhe mënyra e funksionimit të KLP-së detajohen nga nenet 149/a/b/c dhe ç të Kushtetutës, nga Ligji Nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar dhe nga ligji Nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Baza Ligjore

- *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;*
- Ligji Nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar;
- Ligji Nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligji Nr.97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligji Nr.95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, etj.

KLP-ja është organ kolegjal, i përbërë nga njëmbëdhjetë anëtarë, të cilët shërbejnë në detyrë me kohë të plotë. Gjashtë prej anëtarëve të Këshillit janë prokurorë nga të gjitha nivelet e prokurorisë. Pesë anëtarët e tjerë të Këshillit janë juristë jo-prokurorë, të përzgjedhur nga radhët e avokatëve, të pedagogëve të drejtësisë dhe të përfaqësuesve të shoqërisë civile. Këshilli organizohet në 4 (katër) Komisione dhe e ushtron veprimtarinë e tij në mbledhje plenare.

- Anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë:

Zoti Alfred Balla është zgjedhur me vendimin Nr.19/2018, datë 08.02.2018 nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, anëtar i KLP-së si përfaqësues i Shoqërisë Civile. Ai ka përfunduar studimet e larta për drejtësi në vitin 1991 pranë

“Universitetit të Tiranës”; studimet pasuniversitare, master shkencor në të drejtën penale në vitin 2012 pranë Universitetit “Justiniani I-rë” dhe mban titullin Doktor i Shkencave Juridike (e drejtë penale) nga viti 2020 pranë “Universitetit Europian të Tiranës”. Mandati i tij kushtetues 5-vjeçar përfundon në datën 18.12.2023.

Zoti Tartar Bazaj është zgjedhur Anëtar i KLP-së, me Vendimin Nr.19, datë 08.02.2018, nga Kuvendi i Shqipërisë nga radhët e avokatisë. Është diplomuar për Drejtësi pranë Fakultetit të Drejtësisë Tiranë. Mandati i tij kushtetues 5-vjeçar përfundon në datën 18.12.2023.

Zonja Nurihan Seiti është zgjedhur Anëtare e KLP-së, me Vendimin Nr.19, datë 08.02.2018, nga Kuvendi i Shqipërisë nga radhët e avokatisë. Është diplomuar për Drejtësi pranë Fakultetit të Drejtësisë Tiranë. Mandati i saj kushtetues 5-vjeçar përfundon në datën 18.12.2023.

Zoti Moisi Duda është zgjedhur nga Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve, në datë 13 Tetor 2023 nga radhët e prokurorëve të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në pozicionin e anëtarit të KLP-së me një mandat 5 vjeçar. Z. Duda ka mbaruar studimet e larta për drejtësi në vitin 1990, në fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës.

Zoti Olger Eminaj, është zgjedhur Anëtar i KLP-së nga radhët e prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm. Prej datës 19.12.2023, ushtron detyrën e Anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Zonja Ledina Riza është zgjedhur anëtare e KLP-së, nga Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve, si përfaqësuese e Prokurorisë së Apelit Tiranë. Ajo është diplomuar për Drejtësi, pranë Universitetit të Tiranës, në vitin 1993 dhe më pas ka kryer Master Shkencor në të Drejtën Penale, pranë Universitetit të Tiranës. Zonja Riza ushtron detyrën e anëtares së Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nga 1 Nëntori i vitit 2022.

Zoti Vatë Staka është zgjedhur nga Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve, në datë 13 Tetor 2023 nga radhët e prokurorëve të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në pozicionin e anëtarit të KLP-së me një mandat 5-vjeçar.

Zonja Arta Mandro – Balili, me Vendimin Nr.78/2022 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, është zgjedhur anëtare e KLP-së nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës. Zonja Mandro është diplomuar për drejtësi në Universitetin e Tiranës dhe ka titullin akademik "Profesor" prej vitin 2009.

Zonja Mirela P. Bogdani është zgjedhur anëtare e KLP-së me Vendimin Nr.23/2022 të Kuvendit të Shqipërisë, nga trupa e pedagogëve të Fakulteteve të Drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës. Zonja Bogdani ka përfunduar studimet në

Fakultetin e Drejtësisë, Universitetit të Tiranës në vitin 2000 dhe ka titullin akademik “Prof. Assoc.”.

Zoti Sokol Stojani është anëtar i KLP-së, i zgjedhur nga Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve, si përfaqësues i Prokurorisë së Përgjithshme. Mandati i tij në detyrën e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë është një mandat me afat pesë vjeçar, i vlefshëm deri në dhjetor 2026. Zoti Stojani ka kryer studimet e larta në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës përgjatë periudhës 1989 – 1993, ku është diplomuar si jurist.

Zoti Zeqir Hoda është anëtar i KLP-së, i zgjedhur nga Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve, si përfaqësues i Prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë. Prej muajit Dhjetor të vitit 2021 ushtron detyrën si anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Zoti Hoda ka përfunduar studimet në Fakultetin e Shkencave Politiko-Juridike, Dega Filozofi, Universiteti i Tiranës në vitin 1986 dhe në vitin 1996 ka përfunduar studimet në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

C. GJENDJA E BURIMEVE NJERËZORE DHE PROJEKSIONI PËR TRI VITET E ARDHSHE TË SISTEMIT TË PROKURORISË

1. Gjendja e organikave të zyrave të prokurorisë në raport me vakancat faktike

Krijimi i vakancave si pasojë e vijimit të procesit të Vetting-ut ka vijuar të sjellë ndryshime të qenësishme në gjendjen aktuale të sistemit të prokurorisë. Njëkohësisht, përveç sistemit të rivlerësimit kalimtar, i cili të paktën sa i takon Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ka hyrë në vitin e fundit, në zyrat e prokurorive gjatë vitit 2023 ka pasur edhe kërkesa për dorëheqje, largime të prokurorëve që mbushin moshën e pensionit etj., të cilët kanë ndikuar gjithashtu në uljen e numrit të prokurorëve në sistem. Për rrjedhojë, ulja e numrit të prokurorëve ka vijuar të rrisë mbingarkesën e tyre.

Në përgjigje të situatës së krijuar në janar të vitit 2023, është implementuar harta e re gjyqësore, në nivel të prokurorive të apelit, nëpërmjet së cilës është bërë ristrukturimi i këtyre prokurorive, duke shkriur Prokuroritë e Apelit Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë dhe duke i grupuar ato në një të vetme atë të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në Tiranë.

Ndërsa ristrukturimi i prokurorive në nivelin e shkallëve të para, është realizuar nga Këshilli me datë 24.04.2023 dhe ka hyrë në fuqi me datë 01.05.2023. Nëpërmjet këtij ristrukturimi janë shkriur prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës

së Parë Mat, Kavajë, Lushnjë, Përmet, Kurbin, Pogradec, Tropojë, Pukë dhe Krujë. duke i grupuar ato në 13 prokurori dhe përkatësisht në prokuroritë Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë, Kukës, Shkodër, Tiranë, Berat, Elbasan, Sarandë dhe Vlorë.

Më poshtë, do të paraqesim në mënyrë analitike situatën faktike të prokurorive, organikën e miratuar dhe ndarjet përkatëse sipas shkallëve, vakancat e krijuara, të përhershme dhe të përkohshme, prokurorët e komanduar dhe prokurorë të tjerë që nuk e ushtrojnë funksionin për shkaqe të tjera, rastet e mbarimit të funksionit për shkak të dorëheqjes, daljes në pension, apo largimit nga jeta etj.

Në fund të vitit 2023, sistemi i prokurorisë ka qenë i organizuar në:

- a. 13 zyra prokurorie pranë Gjykatave të Shkallëve të Para;
- b. 1 zyrë prokurorie pranë Gjykatave të Apelit;
- c. Prokuroria e Posaçme SPAK;
- d. Prokuroria e Përgjithshme.

Organika totale e miratuar për gjithë sistemin e prokurorive është 341 prokurorë nga të cilët:

- a. 278 në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë;
- b. 26 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm;
- c. 20 në Prokurorinë e Posaçme, SPAK;
- d. 17 në Prokurorinë e Përgjithshme.

Shpërndarja e prokurorëve në zyrat e prokurorive i është nënshtruar riorganizimit sipas urdhrin Nr.19, datë 30.01.2024 të Prokurorit të Përgjithshëm, duke ruajtur numrin e përgjithshëm prej 341 prokurorë në total.

Numri faktik i prokurorëve që ushtronin detyrën në dhjetor 2023 ishte 212 prokurorë, nga të cilët:

- a. 174 prokurorë në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm;
- b. 10 prokurorë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm;
- c. 18 në Prokurorinë e Posaçme, SPAK;
- d. 10 në Prokurorinë e Përgjithshme.

Nga ana tjetër në fund të vitit 2023, kishte gjithsej 129 vakanca, nga të cilat 55 prej tyre janë vakanca të përhershme ndërsa 74 janë vakanca të përkohshme të shkaktuara kryesisht nga vendimet e shkarkimit nga detyra të prokurorëve nga organet e rivlerësimit kalimtar.

Sa i përket prokurorëve të komanduar dhe prokurorëve që i përkasin rasteve të tjerë të parashikuar me ligj, që nuk kryejnë detyrën aktualisht si prokurorë, numri i tyre është 19 prokurorë dhe përkatësisht janë ndarë si më poshtë:

- a. 6 Anëtarë të KLP-së;
- b. 5 të komanduar si këshilltarë në KLP;
- c. 1 në funksionin Këshilltar Etike në KLP;
- d. 4 në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- e. 1 në EUROJUST;
- f. 2 në Prokurorinë e Përgjithshme.

Më poshtë është paraqitur në formë tabelore gjendja për organikën:

Shkalla Parë	Organika	Vakancë e përkohshme	Vakancë e përhershme	Vakancë totale	Në detyrë
Berat	7	1	0	1	6
Dibër	8	0	2	2	6
Durrës	34	8	4	12	22
Elbasan	20	5	3	8	12
Fier	22	9	0	9	13
Gjirokastrë	9	0	2	2	7
Korçë	19	1	7	8	11
Kukës	8	2	2	4	4
Lezhë	14	2	4	6	8
Sarandë	7	2	0	2	5
Shkodër	20	6	1	7	13
Tiranë	90	28	9	37	53
Vlorë	20	4	2	6	14
	278	68	36	104	174

PROKURORIA E APELIT

Organika	Vakancë e përkohshme	Vakancë e përhershme	Shtuar me caktim të përkohshëm	Vakancë faktike	Në detyrë
26	5	12	1	16	10

PROKURORIA E PËRGJITHSHME

Organika	Vakancë e përkohshme	Vakancë e përhershme	Shtuar me caktim të përkohshëm	Vakancë faktike	Në detyrë
17	3	4	0	7	10
20	0	3	1	2	18

Nr.total sipas Organikës	341
Në detyrë si prokuror	212
Të komanduar jashtë sistemit dhe Anëtarë të KLP	19
Vakanca total	129

2. Të dhëna mbi procesin e rivlerësimit kalimtar të Prokurorëve për vitin 2023.

Të dhëna në lidhje me procesit të rivlerësimit kalimtar (vettingut) të realizuar nga KPK-ja dhe KPA-ja gjatë vitit 2023 paraqiten si më poshtë:

- a. Të konfirmuar në detyrë nga KPK-ja 39 prokurorë;
- b. Të shkarkuar nga detyra nga KPK -ja 17 prokurorë;
- c. Të konfirmuar në detyrë nga KPK-ja dhe të ankimuar në KPA- 13 prokurorë;
- d. Të rikthyer në detyrë nga KPA -ja 0 prokurorë;
- e. Të shkarkuar nga detyra nga KPA-ja 18 prokurorë;
- f. Numri i prokurorëve të cilët kanë dhënë dorëheqjen - 4 prokurorë;
- g. Numri i prokurorëve të cilët janë larguar nga sistemi për shkak pensioni - 3 prokurorë.

Numri i prokurorëve që mbeten për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar nga KPK-ja është 33 prokurorë.

Sikurse vihet re edhe këtë vit vakancat e krijuara kryesisht nga procesi i rivlerësimit kalimtar mbeten të konsiderueshme, duke sjellë problematika në lidhje me mbingarkesën e prokurorëve dhe për rrjedhojë mbartjen e dosjeve në vitin pasardhës, fakt i cili pasqyrohet edhe nga raportimi i Prokurorit të Përgjithshëm.

3. Projektioni i gjendjes së sistemit të Prokurorisë në lidhje me vakancat.

Në kuadër të menaxhimit të sistemit të prokurorisë sa i takon burimeve njerëzore, është bërë një projektion mbi vakancat për vitet në vijim. Aktualisht ndjekin studimet 76 studentë nga të cilët 26 emërohen gjatë vitit 2023. Në vitin akademik 2023-2024 KLP-ja ka kërkuar 40 studentë të profilit prokuror.

Numri i vakancave në sistemin e prokurorisë është **55** vakanca të përhershme dhe **74** vakanca të përkohshme.

Nga 74 vakancat e përkohshme, 55 prej tyre janë krijuar nga vendimet e KPK-së dhe KLP-së, ndërsa 19 të tjera janë anëtarët e Këshillit që vijnë nga radhët e prokurorëve ose prokurorë të komanduar.

Sipas një përlogaritje të përafërt (*bazuar në probabilitetin matematikor*), nga 55 vakanca të përkohshme që janë aktualisht, 50 prej tyre pritet të kthehen në vakanca të përhershme.

Deri më datë 31.12.2023 janë edhe 33 prokurorë në detyrë që nuk kanë përfunduar ende rivlerësimin kalimtar nga KPK. Në vlerësim të trendit statistikor të deritanishëm, parashikohet që të krijohen edhe **14 vakanca të përhershme**.

Në fund të vitit 2023 rezultojnë 26 prokurorë, të cilëve iu është ankimuar vendimi i konfirmimit në detyrë dhe pritet të shqyrtohen nga KPA. Për këtë shkak pritet që në vijim të krijohen rreth **16 vakanca** të tjera të përhershme.

Numri i prokurorëve që mbushin moshën e pensionit për tre vitet e ardhshme është 7 prokurorë.

Sipas llogaritjeve të mësipërme, numri total i vakancave të përhershme të pritshme të krijohen pas tre vitesh do të jetë 80 vakanca $50+14+16=80$. Duke i shtuar këtij numri edhe numrin prej 55 vakancash të përhershme aktuale si dhe 7 vakanca që mund të krijohen për shkak të moshës së pensionit, arrihet në konkluzionin që, numri total i vakancave të përhershme përlogaritet në 142 të tilla. *Këtu duhet mbajtur parasysh fakti se është e vështirë të parashikohet faktori i largimeve për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar, çka bën që ky numër mos të jetë plotësisht i saktë*. Në përfundim, prej numrit maksimal prej 142 vakancave potenciale të përhershme duhet të zbresim numrin e studentëve aktualë (76 kandidatë) dhe përfitojmë projektionin e nevojave për 3 (tre) vitet e ardhshme, që është i barabartë me $142-76=66$ vakanca të përhershme.

Sipas nenit 59, pika 2, germa b), të ligjit për statusin, prokurorët e emëruar në Prokurorinë e Posaçme nuk krijojnë vakanca të përhershme, por vakanca të përkohshme. Me përfundimin e mandatit të tyre 9-vjecar, këta magjistratë duhet të kthehen në prokurorinë ku kanë pasur emërimin e mëparshëm, ose në pozicione të tjera në sistemin e prokurorisë. Duke pasur parasysh këtë rregullim, numri i vakancave të përhershme për t'u plotësuar me studentët që duhet të pranohen në vitet në vijim është 49 kandidatë (66-17=49).

Duke pasur parasysh analizën e mësipërme parashikohet që vakancat e sistemit të prokurorisë do të plotësohen në masën më të madhe brenda 3 (tre) viteve në vijim.

D. MARRËDHËNIET NDËRINSTITUCIONALE TË KLP-SË DHE INTEGRIMI EVROPIAN.

4. KLP-ja dhe marrëdhëniet me institucionet e tjera të drejtësisë.

Bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës ka vijuar të jetë intensiv gjatë vitit 2023. KLP-ja ka përmbushur detyrimet e saj ligjore, në komunikim të vazhdueshëm me Shkollën e Magjistraturës, për emërimin dhe caktimin në detyrë të prokurorëve të rinj, verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatëve që aplikojnë për t'u pranuar në Programin e Formimit Fillestar për vitin akademik 2023-2024, miratimi i kalendarëve të trajnimeve vazhdues të prokurorëve etj.

Caktimi në detyrë dhe emërimi i magjistratëve të rinj, profili prokuror, që kanë përfunduar Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës është një detyrë që ligji ia ka ngarkuar KLP-së. Prej momentit të konstituimit të KLP-së, janë caktuar në detyrë dhe emëruar 66 prokurorë të rinj. Gjatë vitit 2023, pas përfundimit të procesit të vlerësimit etiko-profesional, janë emëruar 26 prokurorë.

Duke pasur në konsideratë Ligjin për Statusin, KLP-ja ka detyrimin ligjor të përcaktojë numrin maksimal të kandidatëve magjistratë të profilit prokuror që pranohen në Programin e Formimit Fillestar.

Konkretisht në pikën 1, të nenit 29, të këtij Ligji përcakton se: *“Në janar të çdo viti, Këshillat, pasi kanë kryer një analizë të nevojave, përcaktojnë dhe publikojnë numrin maksimal të kandidatëve magjistratë që pranohen në formimin fillestar për vitin e ri akademik”*.

Gjithashtu referuar Ligjit për Qeverisjen, pika 1, e nenit 183 përcakton se: *“Këshilli Lartë i Prokurorisë bashkëpunon me Shkollën e Magjistraturës për rekrutimin e kandidatëve për prokurorë, në pajtim me këtë ligj dhe ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe emëron prokurorët pas diplomimit në Shkollën e Magjistraturës”*.

Nga sa më sipër, KLP-ja pas një analize të nevojave të sistemit dhe faktorëve që ndikojnë në përcaktimin e numrit maksimal të kandidatëve, si: vendet vakante të

përhershme aktualisht në sistem; numri i studentëve që ndjekin aktualisht Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, kapacitetet e Shkollës së Magjistraturës, prokurorët që mbushin moshën e pensionit në 3 vitet e fundit si dhe, përcaktimi i një trendi të largimeve nga sistemi të prokurorëve në funksion nga organet e rivlerësimit kalimtar, përcaktoi numrin maksimal të kandidatëve magjistratë të profilit prokuror që do të pranohen për vitin akademik 2023-2024 prej 40 kandidatësh magjistratë të profilit prokuror.

Gjithashtu Këshilli ka përmbushur detyrimin për të paraqitur komentet dhe kundërshtimet të raportit të vlerësimit paraprak të kandidatëve që kanë aplikuar për pranimin në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës për vitin akademik 2023 - 2024 për profilin "prokuror".

Në vijim Këshilli ka përfunduar brenda afatit verifikimet e pasurisë dhe figurës për të gjithë kandidatët e shpallur fitues në profilin prokuror, duke i hapur rrugë procesit të formimit fillestar dhe rekrutimit të magjistratëve të rinj.

Në të njëjtën mënyrë është vepruar edhe për kandidatët të cilët në vitin 2023 kanë përfunduar programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës.

Me Vendimin Nr.146, datë 07.06.2023, "*Për fillimin e procedurave të verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatëve për t'u pranuar në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës në vitin akademik 2023-2024*", KLP-ja ka filluar verifikimin për 26 kandidatë, proces i cili ka përfunduar me pranimin e 26 kandidatëve në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës dhe me pranimin e 1 kandidati nga viti paraardhës akademik 2022-2023.

Marrëdhënia ndërinstitucionale me Prokurorin e Përgjithshëm, vlerësohet se ka pasur një rritje në aspektin cilësor. Gjatë këtij viti ka pasur një rritje bashkëpunimi të materializuar nëpërmjet krijimit të grupeve të përbashkëta për hartimin e akteve nënligjore që lidhen me administrimin e dosjeve personale të nëpunësve civilë të sistemit të prokurorisë, përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të rekrutimit, të drejtave dhe detyrimeve, transferimit, pezullimit, disiplinës dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës të kancelarëve të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe këshilltarëve ligjorë jomagjistratë të Prokurorisë së Përgjithshme, procedurën e emërimit të Sekretarit të Përgjithshëm të Prokurorisë së Përgjithshme etj.

Gjithashtu, më datë 13.10.2023, Prokurori i Përgjithshëm thirri Mbledhjen e Përgjithshme të Prokurorëve, prej së cilës do të zgjidheshin tre anëtarët të rinj të KLP-së, nga radhët e prokurorëve të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe të apelit. Në përfundim të votimit u shpallën fitues zoti Vatë Staka, zoti Moisi Duda dhe zoti Olger Eminaj, që zëvendësuan zotin Bujar Sheshi, zonjën Esmeralda Keshi dhe zonjën Eloida Goxhi, mandati kushtetues i të cilëve përfundonte më datë 18.12.2023.

Po kështu, bazuar në pikën 2, të nenit 105, të ligjit për prokurorinë ku përcaktohet se, *“Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme raportojnë, të paktën një herë në vit, në Këshillin e Lartë të Prokurorisë lidhur me ecurinë e veprimtarisë së strukturave përkatëse”*, pranë KLP-së, më datë 17.04.2024, ka raportuar Prokurori i Përgjithshëm, lidhur me veprimtarinë e sistemit të prokurorisë gjatë vitit 2023.

Zoti Olsian Çela paraqiti në mënyrë të përmbledhur raportin mbi veprimtarinë e sistemit të prokurorisë gjatë vitit 2023, në një seancë gjatë së cilës, iu përgjigj edhe pyetjeve të drejtuara nga ana e anëtarëve. Ky raportim u zhvillua në prezencë të mediave dhe partnerëve ndërkombëtarë, ashtu sikurse u realizua të transmetohet live përmes platformës Zoom.

Së fundi, sa i përket bashkëpunimit me Prokurorin e Përgjithshëm, për procesin e vlerësimit etik dhe profesional të prokurorëve, mund të themi se ky bashkëpunim është i vazhdueshëm. Në funksion të procesit të vlerësimit etik dhe profesional të prokurorëve, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me vendimin Nr.95, datë 29.05.2022, miratoi Rregulloren *“Për Vlerësimin etik dhe profesional të Prokurorëve”* dhe aktualisht janë në proces vlerësimi 35 prokurorë (që i përkasin programeve të vlerësimit për vitin 2022 dhe 2023), ashtu sikurse 40 prokurorë të tjerë (që i përkasin programit të vlerësimit për vitin 2024). Kjo rregullore ka në përbërje disa anekse, ku ndër të tjerë edhe Aneksin Nr.2, i cili përmban modelin e tabelave statistikore me të dhënat për secilin prokuror që do të vlerësohet, si dhe të dhënat mesatare për seksionet apo të gjithë Prokurorinë ku ka ushtruar detyrën prokurori i cili vlerësohet.

Plotësimi i tabelave statistikore të miratuara në Aneksin Nr.2, ka hasur vështirësi teknike për shkak të integritetit të disa të dhënave referuese të cilat nuk ishin parashikuar më parë në regjistrat fizikë dhe elektronikë që plotësonin prokuroritë për efekt statistikash. Plotësimi i një pjesë të dhënave statistikore në rrugë manuale ka sjellë vonesa në ecurinë e hedhjes së shortit të dosjeve që do të vlerësohen si pjesë e procesit të mëtejshëm.

Në takimet e zhvilluara me Prokurorin e Përgjithshëm është trajtuar problematika e hasur dhe mundësia e bashkëpunimit në plotësimin e regjistrave fizikë statistikorë me të dhënat që kërkohen për procesin e vlerësimit etiko-profesional të prokurorëve, si dhe nevojën e krijimit të një sistemi të unifikuar elektronik të të dhënave statistikore.

KLP-ja është organi i ngarkuar për vlerësimin e punës të prokurorëve duke përfshirë edhe **ndihmën në rivlerësimin kalimtar**, në bazë të nenit 160, pika 2, germa d, të Ligjit për rivlerësimin.

Komisioni i Vlerësimit vlerëson punën, si dhe përgatit raportet e aftësive profesionale të prokurorëve, në kuadër të rivlerësimit kalimtar, i cili asistohet nga 5 prokurorë të komanduar në pozicionin e këshilltarit, katër prej të cilëve për një

periudhë pesë vjeçare, me anë të vendimeve Nr.42-45, datë 23.02.2023, të KLP-së dhe një prokuror i komanduar në një moment të dytë, me vendimin Nr.375, datë 30.11.2023.

KLP-ja ka miratuar dhe dorëzuar pranë KPK-së për periudhën janar –dhjetor 2023, gjithsej 45 raporte për vlerësimin e aftësive profesionale të prokurorëve, së bashku me materialet që kanë shërbyer për përgatitjen e tyre. Kanë mbetur pa përfunduar vetëm 5 (pesë) raporte të vlerësimit të aftësive profesionale, të cilët parashikohen të mbyllen brenda 2 (dy) muajve të vitit 2024.

Gjithashtu, në zbatim të nenit 64, pika 1 dhe 65 të Ligjit për Statusin, KLP-ja është shprehur me vendim për mbarimin e statusit të magjistratit, për 4 prokurorë, të cilët kanë kërkuar dorëheqjen, duke hequr dorë nga statusi i magjistratit. KLP-ja ka përcjellë pranë organeve të rivlerësimit, KPK-së ose KPA-së, në varësi të fazës në të cilën ndodhej prokurori, vendimin për deklarimin e mbarimit të statusit, në mënyrë të KPK-ja ose KPA-ja të merrte vendim për pushimin e procesit të rivlerësimit.

Lidhur me **raportimin në Kuvend dhe marrëdhëniet** me të, më datë 03.07.2023, Kryetari i KLP-së Alfred Balla relatoi në seancën plenare të Kuvendit mbi veprimtarinë e KLP-së për vitin paraardhës, duke bërë gjithashtu edhe një pasqyrë të gjendjes aktuale të *sistemit të prokurorisë shqiptare, e cila më pas u përmbyll me miratimin në Rezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së KLP-së për vitin 2022”*, po në të njëjtën datë.

Gjithashtu, KLP-ja ka dhënë kontributin e tij për Raportin e Kuvendit, kërkuar për periudhën Prill-Qershor 2023, raportim i cili është ndalur në tri çështje kryesore: Arritjet kryesore në sektor dhe progresi në zbatimin e rekomandimeve të BE; Forcimi i kapaciteteve institucionale; Mbështetja financiare IPA në zhvillimin përkatës të sektorit.

5. KLP-ja në procesin e integritit evropian.

Duke qenë se fokusi aktual, në funksion të bashkëpunimit ndërinstitucional, është integrimi evropian, KLP-ja ka raportuar për Ministrinë e Drejtësisë për monitorimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian, Komitetit të Stabilizim Asociimit dhe Nënkomitetit për Kapitullin 23.

Përveç sa më sipër, KLP-ja ka dhënë kontribute edhe për dokumente të tjerë të rëndësishëm dhe për aktivitete që lidhen me procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

KLP-ja, në cilësinë e anëtarit të Grupit të Punës për Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” ka raportuar për hartimin dhe dërgimin e kontributeve për Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2023, që mbulon

periudhën 01.04.2023-30.06.2023, dhe 01.06.2023-15.09.2023. Periudha 01.01.2023 deri më 15.03.2023, është përcjellë në një raportim të mëparshëm, që mbulon 15.06.2022-15.03.2023.

Gjithashtu, gjatë vitit 2023, KLP-ja ka kryer raportimin lidhur me përmbushjen e treguesit Nr.1, në zbatim të Kontratës Sektoriale “BE për Reformën në Drejtësi”, miratuar me VKM Nr.476, datë 10.07.2019 mbi “Miratimin në parim të Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian”.

Po në kuadër të procesit të negociatave, KLP-ja ka përgatitur kontributin për periudhën Shkurt 2021-Janar 2023, për takimin e Komitetit të Stabilizim Asociimit, ashtu sikurse ka marrë pjesë aktivisht si me kontributin me shkrim, por ashtu edhe në pjesëmarrjen në takimin e katërbëdhjetë të Nënkomitetit “Drejtësi, Liri dhe Siguri”, mbajtur më datat 14-15 Qershor 2023.

Po në kuadër të integritit, Departamenti i Politikave dhe Integritit Evropian në Kryeministri përgatiti modelin e Paketës Semestrare për Integrimin Evropian (PSIE 2023), për të cilën KLP-ja ka raportuar për monitorimin tremujor të planifikimeve të masave.

Gjithashtu, KLP-ja ka kontribuar në hartimin e masave konkrete, në raport me vlerësimet e Komisionit Evropian në raportin e shqyrtimit analitik (screening report) për grupimin e parë “Themelorët”, dhe rekomandimet e nxjerra nga takimi i katërbëdhjetë të Nënkomitetit “Drejtësi, Liri dhe Siguri”, për Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës, miratuar me VKM Nr.736, datë 13.12.2023, për çështjet e gjyqësorit dhe antikorrupsionit.

6. KLP-ja dhe Raporti i Progresit.

Sa i përket Raportit të Progresit të Komisionit Evropian publikuar më datë 12.10.2022¹, në këtë raport thuhet se KLP-ja ka vijuar me procedurën e ngritjes në detyrë të prokurorëve, por nga ana tjetër duhet të sigurojë implementimin e rregullave të ngritjes në detyrë dhe vlerësimin të prokurorëve.

Gjatë vitit 2023, KLP-ja ka përfunduar procedurën e ngritjes në detyrë të 2 prokurorëve në pozicion drejtuesi, respektivisht në Prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë dhe Fier, ndërkohë që ka ende procedura të tjera të papërfunduara. Sa i përket rregullave të ngritjes në detyrë, gjatë vitit 2023, KLP-ja ka miratuar Rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë prokurorisë së posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar”, ndërkohë që rregullorja për ngritjen

¹ https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022_en

në detyrë në shkallë më të larta dhe rregullorja për ngritjen në detyrë në pozicionin e drejtuesit janë miratuar më herët.

KLP-ja duhet sigurojë një bashkëpunim më të ngushtë me Prokurorin e Përgjithshëm, në mënyrë që kuadri ligjor në fuqi të implementohet në mënyrë sa më korrekte. Rritja e këtij bashkëpunimi do t'i japë rëndësi të veçantë vlerësimit etiko-profesional dhe ngritjes në detyrë të prokurorëve. Në vijim të sa më sipër, KLP-ja, sipas këtij raporti, duhet të finalizojë rregullat dhe procedurat e vlerësimit të prokurorëve.

KLP-ja ka vijuar të bashkëpunojë ngushtësisht me Prokurorin e Përgjithshëm. Për më shumë detaje për bashkëpunimin me Prokurorin e Përgjithshëm, referoju pikë D/4, *“KLP-ja dhe marrëdhëniet me institucionet e tjera të drejtësisë”*.

Bashkëpunimi i ngushtë midis institucioneve të qeverisjes së drejtësisë duhet të vazhdojë, shprehet raporti. Në këtë kuadër, raporti thekson se, KLGJ-ja dhe KLP-ja mbajtën mbledhjen e tyre të përbashkët në fund të vitit 2021. Koordinimi midis këtyre institucioneve duhet të kryhet rregullisht.

Sa i përket bashkëpunimit me KLGJ-në dhe organizimit të mbledhjeve të përbashkëta, gjatë vitit 2023, u mbajt më datë 12.5.2023 në qytetin e Korçës kjo mbledhje e përbashkët, ku tematika kryesore e këtij takimi u fokusua tek sfida e Këshillave dhe instrumentat për të reduktuar stokun e çështjeve të prapambetura (backlog-un) në sistemin gjyqësor dhe rolin e KLGJ-së/KLP-së në forcimin e marrëdhënieve me median dhe publikun.

Lidhur me transparencën e vendimmarrjeve në këshill, Raporti i Progresit shprehet se KLP-ja ka publikuar në mënyrë të rregullt vendimet e tij, dhe procesverbalet e mbledhjeve plenare.

Për bashkëpunimin me Shkollën e Magjistraturës, raporti thekson se cilësia e Programit të Formimit Fillestar dhe atij Vazhdues është përmirësuar, por nevojitet një rritje e numrit të studentëve dhe për pasojë e të diplomuarve, duke patur parasysh shkarkimet nga detyra që po vijojnë si pasojë e procesit të Vetting-ut. KLP-ja, nga ana e saj, në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, ka miratuar kalendarin e trajnimeve për vitin akademik 2022-2023.

Sa i përket këtyre gjetjeve dhe rekomandimeve, KLP-ja për vitin akademik 2022-2023 vendosi që numri maksimal i kandidatëve që mund të pranohen në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës të ishte 35 prokurorë, pikërisht duke patur parasysh nevojat e sistemit dhe pasojat e Vetting-ut.

Raporti i Progresit shprehet se parashikimet ligjore për të garantuar procedurat e emërimit, ngritjes në detyrë, vlerësimit dhe disiplinës janë në fuqi, ashtu sikurse mundësia për të ankimuar çdo vendim në lidhje me to.

7. Kontributi i KLP-së për dokumente strategjike dhe projektakte të sjella për mendim.

KLP-ja ka vijuar të raportojë për Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë, Planin e saj të Veprimit dhe Pasaportën e Indikatorëve, për të cilën Ministria e Drejtësisë është institucion koordinues. Për këtë dokument të rëndësishëm strategjik, KLP-ja ka përgatitur kontributin për periudhën Janar-Qershor 2023, si dhe kontributin vjetor në kuadër të kësaj strategjie.

Përveç Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, KLP-ja ka dhënë kontribut edhe për Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur, Planit të saj të Veprimit, si dhe Pasaportës së Indikatorëve, për të cilën ka përgatitur kontributin për periudhën Janar-Qershor 2023, si dhe kontributin vjetor në kuadër të kësaj strategjie, si dhe ka dhënë mendime/sugjerime edhe për Draft-Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2023-2030 dhe Planit të saj Veprimit 2023-2025 dhe Draft-Strategjinë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimin 2024-2030.

Gjithashtu, në mbështetje të ligjit për qeverisjen, KLP-ja ka dhënë mendim për disa projektakte si:

- Projektvendimi “*Për miratimin e udhërrëfyesit për shtetin e së drejtës*”;
- Projektvendimi “*Për përcaktimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Gardës së Republikës*”;
- Projektvendimi “*Për disa shtesa në vendimin Nr.597, datë 13.10.2021, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e personaliteteve dhe objekteve të tjera që ruhen dhe mbrohen nga Garda e Republikës së Shqipërisë”*” i ndryshuar;
- Projektvendimi “*Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin Nr.478, datë 10.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për procedurën e sigurisë së gjyqtarëve të Gjykatave kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, të Prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme dhe Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit”*”;
- Projektvendimi “*Për ngarkimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si autoritet kontraktor për realizimin e projektit të shtesës së godinës “Poli i Drejtësisë” në funksion të Shkollës së Magjistraturës*”;
- Projektvendimi “*Për miratimin në parim të Konventës Lubjanë-Hagë*”, “*Për bashkëpunimin ndërkombëtar për hetimin dhe ndjekjen penale të krimin të gjenocidit krimeve kundër njerëzimit, krimeve të luftës dhe krimeve të tjera ndërkombëtare*”,

- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”;
- Projektvendimi “Për miratimin në parim të Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Programin e Drejtësisë”;
- Projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin Nr.972, datë 2.12.2020, të Këshillit të Ministrave “Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë””;
- Projektligji “Për dhënie amnistie”;
- Projektvendimi “Për disa ndryshime në vendimin Nr.538, datë 8.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për garantimin e rregullit e të sigurisë në gjykata dhe prokurori””;
- Projektvendimi “Për disa shtesa dhe një ndryshim në vendimin Nr.564, datë 31.07.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret dhe procedurat për mbrojtjen e vecantë të magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit ose për shkak të tij””;
- Projekturdhri “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e strategjisë ndërsektoriale të drejtësisë 2024 – 2030, të planit të veprimit dhe të pasaportës së treguesve”;
- Projekturdhri “Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës për hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimin 2024-2030, të Planit të Veprimit dhe të Pasaportës së Treguesve”;
- Projektudhëzimi “Për përcaktimin e rregullave për regjistrimin e vendimeve gjyqësore penale dhe rehabilitimin ligjor nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore”;
- Projektligji “Për një ndryshim në ligjin Nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar””;
- Projektligji “Për të drejtën e informimit”.

KLP-ja ka raportuar edhe për Planin Kombëtar për Aderimin në Bashkimin Evropian 2024 – 2030 (PKABE) dhe për Planin Kombëtar për Integrimin Evropian PKIE 2024-2026 (PKIE). Ky raportim ka mbuluar veprimtarinë e KLP-së për vitin 2023.

Programi Kombëtar për Aderimin në Bashkimin Evropian (PKABE) ka si synim të adresojë përmes masave politike dhe ligjore, institucionale, zbatuese dhe investimeve përkatëse, linjëzimin e të gjithë kuadrit rregullator shqiptar me *acquis* të BE-së si dhe zbatimin efektiv të tij.

Për këtë, KLP-ja ka raportuar në seksionin narrativ, duke patur parasysh edhe diskutimet dhe rekomandimet e dhëna gjatë procesit të shqyrtimit analitik (*screening*) dypalësh, ku përfshihen iniciativat, reformat dhe prioritetet e planifikuara.

E. TRANSPARENCA NDAJ PUBLIKUT DHE MEDIAVE.

8. KLP-ja dhe e drejta për informim.

Transparenca ndaj medias dhe publikut në sistemin e drejtësisë në përgjithësi, por edhe në atë të prokurorisë në veçanti, është kthyer në një nga momentet më të rëndësishme të punës së KLP-së. Duke përmbushur detyrimin ligjor në lidhje me transparencën institucionale, KLP-ja, edhe gjatë vitit 2023, i ka dhënë një vëmendje të veçantë komunikimit publik mes tij dhe palëve të treta, përfshirë këtu median, institucionet e tjera publike, organizatat, përfaqësitë ndërkombëtare, etj. Me qëllim rritjen e besimit të publikut tek institucionet, KLP-ja ka treguar gjithnjë një kujdes të veçantë në jetësimin e një marrëdhënieje të konsoliduar mes institucionit dhe partnerëve mediatikë, duke rritur në këtë mënyrë edhe nivelin e transparencës.

Duke qenë se kërkesa për informacion është mekanizmi i duhur për të marrë informacion, kur ai nuk është publik në faqe zyrtare, në zbatim të ligjit Nr.119/2014, “*Për të drejtën e informimit*”, i ndryshuar, po ashtu dhe në përmbushje të detyrimeve ligjore të specifikuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë vitit 2023, Këshilli ka siguruar akses në informacionin e kërkuar nga çdo shtetas, institucion apo subjekt tjetër, duke trajtuar kërkesat përmes kthimit të përgjigjeve, delegimit apo orientimit të kërkesave për informacion të publikut, brenda afateve ligjore në fuqi.

Në mbështetje të Urdhrit Nr.187, datë 18.12.2020, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Këshilli ka përditësuar disa prej rubrikave të Programit të Transparencës në faqen zyrtare të internetit, sipas ndryshimeve të ndodhura gjatë kësaj periudhe.

Në përputhje me këtë Urdhër është përshtatur rubrika “*Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve*”, duke respektuar kushtet teknike të faqes zyrtare. Në këtë kategori janë publikuar kërkesat për informacion të ardhura gjatë gjithë vitit 2023 në adresë të Këshillit.

Përgjatë vitit 2023, Këshilli ka administruar dhe trajtuar një numër prej 31 (*tridhjetë e një*) kërkesash, në formatin elektronik dhe përmes shërbimit postar. Këto kërkesa janë trajtuar brenda afateve ligjore dhe kanë marrë përgjigje, për 15 (*pesëmbëdhjetë*) prej tyre përmes shërbimit postar, 14 (*katërmëdhjetë*) përmes

postës elektronike zyrtare të Këshillit dhe për 2 (dy) prej tyre përmes proceseve gjyqësore, të cilat ishin në zhvillim.

Nga kërkesat për informacion drejtuar Këshillit, në 3 (tre) raste është vlerësuar i nevojshëm delegimi i tyre tek institucionet përkatëse si ILD, KPK, KPA dhe Prokurori i Përgjithshëm, duke qenë se lënda objekt kërkimi për informacion nuk përfshihej në fushën e kompetencave të Këshillit, ndërsa 28 (njëzet e tetë) kërkesat e tjera kanë marrë përgjigje të plotë. Një pjesë e mirë e tyre vijnë nga operatorë të medias, studio ligjore dhe përmbarimore, qytetarë por edhe nga institucione shtetërore apo organizata jofitimprurëse.

Përgjatë vitit 2023 janë rishikuar edhe disa nga nën zërat e dritareve e Programit të Transparencës, ku është paraqitur një prezantim më i plotë i anëtarëve të rinj të Këshillit dhe strukturës organizative, struktura dhe nivelet e pagave, detajimi i buxhetit, projektbuxheti afat-mesëm, etj. Kuadri ligjor, po ashtu ka pësuar përditësime dhe plotësime me aktet nënligjore, si procese pune në vazhdim të Këshillit dhe janë pasqyruar në program, raportet vjetore si dhe marrëdhëniet me institucionet e tjera.

Nën drejtimin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, aktualisht po punohet për formatin e ri të “Regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit” (REKPDI), si mekanizëm i Regjistrin Elektronik të Pyetje-Përgjigjeve. Ky instrument do të krijohet duke mbështetur në VKM Nr.145, datë 13.03.2018, “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore “Regjistri elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit”, dhe do të jetë nën administrimin dhe mbikëqyrjen e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

9. Aktivitetet e KLP-së gjatë vitit 2023 dhe informimi publik



a. Nis punën Prokuroria e vetme e Apelit pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë

Në kuadër të zbatimit të Hartës së re Gjyqësore, të miratuar për sistemin gjyqësor, më 1 shkurt 2023, ka nisur aktivitetin Prokuroria e Apelit pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Me rastin e fillimit të veprimtarisë, në ambientet e Prokurorisë u zhvillua një ceremoni ku morën pjesë Kryetari i Këshillit z. Alfred Balla, Kryetarja e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale në KLP, znj.

Nurihan Seiti dhe Prokurori i Përgjithshëm z. Olsian Çela. Ata i uruan suksese strukturës së re dhe ndanë me prokurorët problematikat që ka shkalla e dytë e prokurorisë në vend.



b. Takimi i kreut të KLP-së me përfaqësues të programeve të BE-së në fushën e drejtësisë

Kryetari i KLP-së, z. Alfred Balla priti në një takim, përfaqësues të programeve të Bashkimit Evropian në fushën e Drejtësisë. Delegacioni kryesohej nga Sekretarja e Përgjithshme e Rrjetit Evropian të Trajnimeve Gjyqësore (EJTN), znj. Ingrid Derveaux dhe kishte në përbërje drejtuesin e “Projektit Ëestern Balkans II”, z.Giovanni Pasqua dhe menaxheren e këtij Projekti, znj.Vanja

Tekic.

Në fokus të këtij takimi ishte mbështetja e BE-së për trajnimet vazhduese për prokurorët e Shqipërisë, përmes vendeve anëtare. Kryetari i Këshillit, zoti Balla e informoi zonjën Derveaux, për aktivitetin trajnues e sfidat e institucionit dhe shprehu vlerësimin e falënderimet mbi mbështetjen e BE-së, për sistemin e prokurorisë shqiptare.



c. Takimi i kreut të KLP-së, z. Balla me Kryeprokuroren e Kroacisë

Kryetari i KLP-së, zoti Alfred Balla, priti në ambientet e Këshillit një delegacion nga sistemi i prokurorisë kroate, i kryesuar nga Prokurorja e Përgjithshme e Kroacisë, zonja Zlata Hrvoj-Šipek.

Gjatë këtij takimi u shkëmbyen mendime dhe eksperiencia për të dyja sistemet respektive të prokurorive në

Kroaci dhe Shqipëri. Takimi i kryeprokurores kroate u zhvillua në kuadër të bashkëpunimit dhe të disa takimeve që ajo pati në vendin tonë, me drejtues të institucioneve të reja të drejtësisë si z. Olsian Çela, z. Altin Dumani etj.



d. Takimi i Përbashkët Vjetor mes KLP-së dhe KLGJ-së

Mbledhja e Përbashkët Vjetore e dy Këshillave të Lartë, atij Gjyqësor dhe të Prokurorisë u zhvillua më datë 12.05.2023 në qytetin e Korçës, me bashkëfinancim të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian.

Të pranishëm ishin anëtarë të dy këshillave, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani,

përfaqësuesi i Gjykatës Kushtetuese, Z. Ilir Toska, Zv. Ministria e Drejtësisë, Zj. Adea Pirdeni, përfaqësuesi i Prokurorit të Përgjithshëm, Z. Kostaq Beluri, Kryetarja e Gjykatës së Posaçme Antikorrupsion, Zj. Irena Gjoka, përfaqësues evropianë nga programi CEPEJ, përfaqësues amerikanë nga programi OPDAT, gjyqtarë, prokurorë dhe këshilltarë ligjorë.

Takimi nisi me fjalët përshëndetëse të Kreut të KLP-së, z. Alfred Balla dhe Zv. Kryetarit të KLGJ-së, z. Ilir Rusi. Disa nga temat të cilat u diskutuan gjatë këtij takimi ishin “Sfida e Këshillave dhe instrumentet për të reduktuar stokun e çështjeve të prapambetura në sistemin gjyqësor” si dhe “Roli i KLGJ-së/KLP-së në forcimin e marrëdhënieve me Median dhe Publikun”.

e. Takim me drejtuesen e projektit EU4JUSTICE, zonjën Laura Liguori



I shoqëruar nga anëtarët e KLP-së, zonjat Arta Mandro, Esmeralda Keshi dhe Mirela Bogdani, kreu i KLP-së, zoti Alfred Balla, mirëpriti në një takim zyrtar, drejtuesen e projektit EU4JUSTICE, zonjën Laura Liguori.

Gjatë këtij takimi, anëtarët e KLP-së, njohën zonjën Liguori me temat dhe aspektet ku Këshilli gëzon interes maksimal për të vazhduar jo vetëm bashkëpunimin me instancat ndërkombëtare por edhe për të siguruar një ndihmë teknike. Disa prej

temave që u diskutuan në këtë takim ishin mbështetja me ekspertizë për hartimin e rregulloreve të veçanta që parashikon Ligji për Statusin të cilat janë ende në proces, si dhe trajnimeve të anëtarëve të Këshillit, lidhur me standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin në fuqi, si dhe praktikat më të mira që lidhen me

garantimin e statusit të prokurorit, sidomos vlerësimet profesionale, proceset disiplinore etj., ashtu edhe trajnimeve për administratën e Këshillit, kryesisht në fushën e administrimit dhe të teknologjisë; trajnime të Këshilltarëve ligjorë lidhur me standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin në fuqi sipas profilit të veprimtarisë së tyre pranë komisioneve të përhershme të Këshillit; kryerja e vizitave studimore pranë institucioneve homologe në rajon apo në vendet e BE-së për të parë nga afër praktikat më të mira të punës dhe shkëmbimin e eksperiencave, lidhur me garantimin e statusit të prokurorit.



f. Intervista e kreut të KLP-së, z. Balla në “BREAKING NEËS”

Kryetari i KLP-së, zoti Alfred Balla, ishte i fuar në emisionin e mesditës. ‘Breaking’ në Top Media.

Në kushtet kur gjithnjë e më shumë, interesimi dhe vëmendja e publikut ndaj sistemit të drejtësisë është rritur dhe pritshëmritë e qytetarëve janë më të mëdhaja, kreu i KLP-së është

ndalur për të dhënë një pasqyrim më të detajuar të punës së Këshillit, por edhe të opinioneve të tij lidhur me ndryshimet e bëra së fundi në sistemin e drejtësisë në përgjithësi dhe të prokurorisë në veçanti.



g. Takim i kreut të KLP-së, me Kreun e Inspektoratit të Përgjithshëm të Drejtësisë së Republikës së Francës

Kreu i KLP-së, zoti Alfred Balla priti, më datë 02.06.2023, në një takim zyrtar zotin Christophe Straudo, Shef i Inspektoratit të Përgjithshëm të Drejtësisë së Republikës së Francës i shoqëruar nga zoti Artur Metani, Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Zoti Balla i prezantoi zotit Straudo aspektin

legjislativ të KLP-së lidhur me marrëdhëniet institucionale me ILD-në, por edhe bashkëpunimin konkret i cili tashmë është në nivelin më të lartë mes institucioneve.

Në përfundim të analizës së punës u vërejt se problematikat e përbashkëta të evidentuara në procedurat disiplinore të kryera nga ana e strukturave të të dyja shteteve, lidheshin kryesisht me pamjaftueshmërinë e përgatitjes profesionale të

magjistratit dhe integritetin e tij gjatë ushtrimit të detyrës. Njëkohësisht, u theksua se, në të dyja sistemet si atë shqiptar edhe atë francez, mbetet ende sfidë rekrutimi i magjistratëve të rinj.

Zoti Balla i parashtrori zotit Straudo domosdoshmërinë e inspektimeve tematike më të shpeshta nga ana e ILD-së, të cilat për KLP-në janë thelbësore për të krijuar një tablo të punës së prokurorëve e cila do të shërbejë për një vlerësim të veprimtarisë etike dhe profesionale më objektiv për secilin prej prokurorëve.

Në fund zoti Balla shprehu falënderimet për mbështetjen e Ambasadores së Republikës së Francës zonjës Elisabeth Barsacq në takimin e kryer dhe i parashtrori zotit Straudo kërkesë për kryerjen e takimeve të vazhdueshme me qëllim shkëmbimin e eksperiencave.



h. Takim me Këshillin e Lartë Prokurorial të Kosovës

Kreu i KLP-së dhe anëtarët e tij, mirëpritën në një takim delegacionin e Këshillit të Lartë Prokurorial të Kosovës. Delegacioni Kosovar, i përbërë nga kreu i Këshillit, z. Jetish Maloku, Besim Kelmendi Kryeprokurori i Shtetit; z.Veton Shabani Zëvendëskryesuesi i KPK-së; z.Blerim Isufaj, Kryeprokurori i

Prokurorisë Speciale; z. Armend Zenelaj - Anëtar i Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Kryetar i Komisionit për Çështje Normative; znj. Arjana Shajkovci - Anëtare e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Kryetare e Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel, z. Ardian Hajdaraj - Anëtar i Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Kryetar i Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve dhe Drejtoresha e Përgjithshme e Sekretariatit të KPK-së, zhvilluan një vizitë zyrtare dy ditore në 29- 30 Qershor 2023, në institucionet e larta të drejtësisë në Shqipëri.

Qëllimi i kësaj vizite ishte fuqizimi i bashkëpunimit mes dy institucioneve të drejtësisë si dhe diskutimi i një sërë çështjesh me rëndësi në lidhje me sistemin e prokurorisë për të dyja vendet në kuadër të bashkëpunimit në luftën kundër krimit dhe veprimtarinë etike dhe profesionale të prokurorëve.

Në fillim, delegacioni Kosovar është mirëpritur nga kreu i KLP-së, z. Alfred Balla dhe anëtarët e Këshillit, në ambientet e institucionit dhe më pas janë takuar edhe me drejtues të institucioneve të tjera të larta të drejtësisë në Shqipëri, si z. Artur Metani, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, znj.Naureda Llagami Kryetare dhe z.Ilir Rusi Nënkryetari i KLGJ-së.



i. Ceremonia e Betimit të 26 Prokurorëve të rinj, përpara Këshillit të Lartë të Prokurorisë

Më 21 korrik 2023, në ambientet e godinës së ‘Polit të Drejtësisë’ është zhvilluar ceremonia e betimit të 26 magjistratëve prokurorë të sapo diplomuar, përpara trupës së KLP-së.

Të pranishëm në këtë ceremoni ishin anëtarët e Këshillit, Prokurori i

Përgjithshëm, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Ministri i Drejtësisë, Zv.Kryetari i KLGJ-së, Përfaqësuesi i Shkollës së Magjistraturës, Përfaqësuesja e Programit OPDAT, Drejtuesja e projektit EU4JUSTICE, Prokurori i etikës në KLP, Drejtuesit e zyrave të Prokurorive, etj.

Pas nderimit të Himnit Kombëtar mbajtën fjalën e tyre përshëndetëse Kryetari i Këshillit, zoti Balla, Prokurori i Përgjithshëm, zoti Çela, Ministri i Drejtësisë, zoti Manja, Prokurorja e renditur e para zonja Hako.



j. Takimi i kreut të KLP-së, me Ministrin e Brendshëm, z. Taulant Balla

KLP-ja mbështet Ministrinë e Brendshme dhe Policinë e Shtetit në intensifikimin e goditjes së fenomenit të shpërndarjes së lëndëve narkotike dhe vlerëson pozitivisht propozimin për ashpërsimin e dënimeve ndaj veprave kriminale të kryera brenda perimetrit të sigurisë

së shkollave.

Gjatë takimit të zhvilluar mes Kryetarit të KLP-së, zotit Alfred Balla dhe Ministrit të Brendshëm zotit Taulant Balla, u diskutua gjithashtu edhe për një politikë penale më të ashpër kundër zjarrvënësve.

KLP-ja bashkëpunon me Agjencinë e Mbikqyrjes Policore për kryerjen e Vetting-ut në momentin e pranimit dhe përfundimit të Shkollës së Magjistraturës, për magjistratët e ardhshëm prokurorë. Kjo praktikë tashmë e konsoliduar duhet të çohet më tej.

Pikë tjetër e diskutimit mes dy krerëve ishte dhe efica e Oficerëve të Policisë Gjyqësore pranë Drejtorive të Policisë ku KLP-ja vëren mungesë stabiliteti, që

shkaktohet nga lëvizjet e shumta mes radhëve të këtyre oficerëve. Gjatë takimit u diskutua dhe mbi veprimtarinë e Komisionit të Mbrojtjes së Prokurorëve (i cili

drejtohet nga KLP-ja) ku ka përfaqësues të Ministrisë së Brendshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë.



k. Takimi i kreut të KLP-së, z. Alfred Balla me Kryetarin e KPK-së, z. Roland Ilia

Takimi u zhvillua në kuadër të marrjes së detyrës së re të zotit Ilia si Kryetar i KPK-së. Zoti Balla uroi kryetarin e KPK-së për detyrën e re.

Në fokus të këtij takimi ishte vijueshmëria e bashkëpunimit mes institucioneve në funksion të procesit të rivlerësimit kalimtar të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

Drejtuesit e dy institucioneve vlerësuan marrëdhëniet e mira institucionale të vendosura prej vitesh, shkëmbyen mendimet e tyre në lidhje me punën e kryer deri tani, si dhe shprehën angazhimin dy palësh për të vijuar me tej punën deri në përmbylljen me sukses të procesit i cili po pastron sistemin nga të paftët e të korruptuarit.



l. Takim me përfaqësuesit e Këshillit të Lartë Gjyqësor të Republikës së Bullgarisë

Kryetari i Këshillit, zoti Alfred Balla dhe Zëvendëskryetari zoti Tartar Bazaj zhvilluan sot një takim me zonjën Tsvetinka Pashkunova, zonjën Kalina Chapkanova, zonjën Svetlana Boshnakova dhe zotin Stefan Petrov, përfaqësues të Këshillit të Lartë Gjyqësor të Republikës së Bullgarisë.

Zoti Balla paraqiti shkurtimisht vendimmarrjet më të rëndësishme të realizuara nga Këshilli përgjatë këtyre 5 vjetëve të krijimit dhe funksionimit të tij si: ngritja dhe krijimi i SPAK dhe përzgjedhja e drejtuesit të kësaj strukture të posaçme, përzgjedhja dhe emërimi i Drejtuesit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, Prokurorit të përgjithshëm, si dhe informoi përfaqësuesit e KLGj-së së Republikës së Bullgarisë mbi procedurat e emërimit, zhvillimit të karrierës, të procesit të

vlerësimit të prokurorëve dhe mbi kuadrin ligjor që rregullon procedurat e magjistratëve prokurorë në vendin tonë.

Zëvendëskryetari zoti Tartar Bazaj, theksoi veçanërisht rëndësinë dhe suksesin në krijimin e SPAK, strukturë e cila derimë tani ka shfaqur vendosmëri në hetim dhe rezultate deri në nivele të larta të funksionarëve në vendit tonë. Në vijim, u shkëmbyen eksperiencia lidhur me konkurrimin, mënyrën e përzgjedhjes, organet përkatëse, si dhe verifikimin e deklaratave të pasurisë dhe figurës për magjistratët e rinj në çastin e emërimit.

Në fund, zoti Balla theksoi se, reforma në drejtësi ndër të tjera ka sjellë përmirësim të mënyrës së kryerjes së hetimit nga prokurorët, e cila tashmë është e decentralizuar duke i dhënë pavarësi të plotë prokurorit në ushtrimin e detyrës.



m. Vizita dy ditore e KLP-së në Këshillin Prokurorial të Republikës të Kosovës

Gjatë vizitës së tij dy-ditore, përfaqësues të KLP-së, u pritën në Këshillin Prokurorial të Kosovës nga anëtarët e këshillit dhe Kryetari i tij, zoti Jetish Maloku, në zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit nga Kryeprokurori zoti Besim Kelmendi së bashku me drejtuesin e Prokurorisë

Speciale zotin Blerim Isufaj; në Këshillin Gjyqësor të Kosovës nga drejtuesi zoti Albert Zogaj.

Ndërkohë, KLP-ja u përfaqësua nga Kreu i tij, z. Alfred Balla, Zëvendëskryetari z. Tartar Bazaj si dhe anëtarët e këshillit, z. Bujar Sheshi, z. Zeqir Hoda, znj. Eloida Goxhi, znj. Arta Mandro dhe znj. Mirela Bogdani.

Gjatë këtyre takimeve institucionet shkëmbyen problematika dhe ide me vlerë në rrugën e konsolidimit të drejtësisë shqiptare në dy trojet tona.



n. Kreu i KLP-së pret në takim përfaqësuesit e Misionit Taiex, të Atashuar në Delegacionin e BE-së në Shqipëri

Kryetari i Këshillit, zoti Alfred Balla zhvilloi sot, më 26 shtator 2023 në ambientet e Këshillit, një takim me: zotin Giovanni Pasqua, zotin Carmine Pirozzoli, zotin Dario Quintavalle, zotin Aleksandar Romanovic dhe zonjën Tidita Fshazi, përfaqësues të Misionit

TAIEX, të BE-së i cili monitoron eficientësinë e shtetit gjyqësor në Shqipëri

Kryetari iu uroi mirëseardhjen dhe falënderoi për ndihmën dhe mbështetjen e dhënë nga BE-ja, në përgjithësi për reformën në drejtësi të ndërmarrë në vendin tonë dhe në veçanti nëpërmjet ndihmës teknike të akorduar për institucionet e reja të krijuara.

Përfaqësuesit e misionit bënë një prezantim të programit të tyre të punës dhe shfaqën interes në disa çështje të cilat konsistojnë në eficientësinë me miratimin e hartës gjyqësore, kontrollin e organit të akuzës lidhur me kërkesat dhe zbatimin e masave të sigurimit me karakter personal, marrëdhëniet ligjore midis organit të akuzës dhe atë gjyqësor, bashkëpunimi midis KLGj-së dhe KLP-së, etj.

Zoti Balla bëri një panoramë të situatës aktuale të zyrave të prokurorive në vend duke informuar për të gjitha pyetjet e misionit dhe në përfundim, pjesëmarrësit në takim vlerësuan maksimalisht informacionin dhe idetë e shpalosura për mbarëvajtjen e punës në sistemin e prokurorisë.



o. Takim me Kryetarin dhe përfaqësues të Komisionit të Prokurimit Publik

Kryetari i Këshillit, zoti Alfred Balla priti sot, më 27 shtator 2023, në një takim zotin Jonaid Myzyri, Kryetar i Komisionit të Prokurimit Publik i cili, shoqërohej nga Komisioneri zoti Kreshnik Tërnova.

Zoti Myzyri informoi Kryetarin lidhur me kuadrin ligjor në fushën e prokurimit dhe mbi bashkëpunimet

ndërkombëtare të institucionit që drejton, si dhe shpalosi disa tema ku dy institucionet mund të ndërveprojnë.

Interesi i një kontributi të përbashkët do të ishte veçanërisht në përfshirjen e kurrikulave të programit të trajnimit vazhdues të prokurorëve pranë Shkollës së Magjistraturës, përsa i përket legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë për procedurat e prokurimit publik, koncesioneve/ partneritetit publik privat, ankandeve publike dhe procedurave konkurruese të dhënies së lejeve minerare. Gjithashtu, pjesë e bashkëpunimit në vazhdimësi, u propozuan të jenë edhe organizimi i tryezave të punës dhe/ose seminareve të ndryshme me panel ekspertësh vendas e ndërkombëtar me pjesëmarrjen e magjistratëve me profil prokuror.

Ndërmjet kryetarëve të institucioneve u dakordësua formalizimi i bashkëpunimit nëpërmjet nënshkrimit të një memorandumi.



p. Takim i Reporterëve të Këshillit të Evropës me kreu e KLP-së, z. Alfred Balla

Më datë 27.09.2023 në ambientet e KLP-së, kreu i Këshillit, z. Alfred Balla priti një delegacion të Reporterëve të Këshillit të Evropës.

Reporterët ishin të interesuar dhe kërkuan informacion për sfidat dhe prioritetet e KLP-së deri më tani

dhe projektet për të ardhmen, pasojat në aksesin në drejtësi dhe efikasitetin e zbatimit të hartës së re gjyqësore, masat që duhen/janë marrë për zbutjen e largimeve të prokurorëve për efekt të zbatimit të reformës në drejtësi dhe vetingut, etj.



q. Takim me z. Vincent Macq, Ekspert i Projektit CEPEJ dhe përfaqësues të Këshillit të Evropës

Anëtarja e Këshillit, zonja Nurihan Seiti, zhvilloi, më 22 nëntor 2023, një takim me zotin Vincent Macq, ekspert i projektit CEPEJ dhe përfaqësueset e projektit SEJIIV, në ambiente e KLP-së.

Zonja Seiti i uroi mirëseardhjen dhe i falënderoi për ndihmën dhe mbështetjen e dhënë nga BE në përgjithësi për reformën në drejtësi të ndërmarrë në vendin tonë dhe në veçanti nëpërmjet ndihmës teknike të akorduar për institucionet e reja të krijuara.

Zoti Macq, informoi zonjën Seiti mbi qëllimin e vizitës e cila, kryhet në kuadër të pasqyrimin të nevojave dhe pritshmërive që ka Këshilli me qëllim vlerësimin e detajuar të këtyre nevojave dhe kontributin konkret nëpërmjet rekomandimeve dhe bashkëpunimeve të mëtejshme.

Ajo gjithashtu vuri theksin në procesin e vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale të prokurorëve që kryhet pikërisht nga Komisioni në të cilin bën pjesë në cilësinë e Kryetares, duke parashtruar punën voluminoze të kryer këtë vit, që nga shortimi i 35 prokurorëve të parë dhe vështirësitë konkrete të ndeshura përgjatë procesit, përfshirë këtu procedurën e shortimit, mbledhjen e të dhënave, përpunimin e tyre etj.

Në këtë kuadër, zonja Seiti kërkoi ndihmë konkrete lidhur me pasjen e një moduli dhe implementimin e një sistemi automatik i cili, konsiderohet jetik pasi, procesi përfshin procedura që angazhojnë burime njerëzore për një kohë të gjatë, për shkak të mbledhjes së të dhënave në mënyrë manuale nga zyrat përkatëse të prokurorëve. Ky sistem elektronik i menaxhimit të dosjeve do duhet të përmbajë të dhëna që me regjistrimin e kallzimit penal, fazat e hetimit, dërgimin e çështjes për gjykim dhe vendimin përkatës, do të jetë ndihmë thelbësore në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të prokurorëve.

Në përfundim, zonja Seiti dhe zoti Macq dakordësuan për vijimin e bashkëpunimit me qëllim shkëmbimin e eksperiencave mbi procese të njëjta që zhvillohen në vende të tjera të Bashkimit Evropian.

F. Veprimtaria administrative dhe proceset gjyqësore.

10. Struktura dhe organigrama e KLP-së.

KLP-ja me Vendimin Nr.36, datë 06.03.2019, "*Për miratimin e strukturës organizative të administratës së KLP-së*", ka miratuar strukturën organizative, në përputhje me nenin 178, të Ligjit për Qeverisjen, ku ishin përcaktuar qartë mënyra e organizimit dhe njësitë mbështetëse të administratës së KLP-së.

Struktura organizative e KLP-së përbëhet nga 65 punonjës.

Pas kërkesës së KLP-së përpara Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtave të Njeriut në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, dhe miratimit pjesërisht të këtyre kërkesave, u përcaktua se organika do të përbëhet prej 72 punonjësish e për rrjedhojë, u vendos një rikonfigurim të strukturës organizative.

KLP-ja me Vendimin Nr.73, datë 24.04.2023, “Për miratimin e strukturës organizative të administratës së KLP-së”, miratoi strukturën e re organizative. Në këtë strukturë të re u vendos që të mbylleshin 5 pozicione pune nga struktura e kaluar dhe më konkretisht:


- 1 pozicion i nivelit të lartë drejtues - Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Ligjore;
- 1 pozicion i nivelit të mesëm drejtues - Drejtor i Përgjithshëm;
- 2 punonjës të Kabinetit të titullarit - Këshilltar dhe ndihmës i Kryetarit;
- 1 punonjës administrativ - Nëpunës informacioni

dhe u krijuan 12 vende të reja si më poshtë vijon:

- 1 pozicion i nivelit të mesëm drejtues - Këshilltar ligjor;
- 2 pozicione të nivelit të ulët drejtues - Shef sektori TIK dhe Shef Sektori protokoll arkive;
- 5 pozicione të nivelit ekzekutive - Specialist redaktor, Specialist trajnimesh, Specialist IT, Specialist prokurimesh, dhe Specialist protokollit;
- 4 pozicione punonjës administrative - Shofer.

Struktura organizative aktuale e KLP-së është e përbërë nga 72 punonjës dhe në fund të vitit 2023, në KLP ka pasur 67 punonjës faktik.

STRUKTURA E MIRATUAR NGA KLP-ja



ORGANIGRAMA E KLP-së

Funksioni	Kategoria/Klasa	Numri
Kryetar	G3*	1
Zëvendëskryetar	G3*	1
Anëtar	G3*	9
Këshilltari i Etikës	G3*	1
Drejtor Kabineti	I-a	1
Këshilltar Kabineti	I-b	2
Sekretar i Përgjithshëm	I-a	1
Drejtor drejtorie	II-a	1
<i>Njësia e Mbështetjes së Komisioneve</i>		
Këshilltar Ligjor	II-b	16
<i>Njësia e Mbështetjes së Komisioneve</i>		
Shef Sektori		
Sektori i Dokumentimit të Seancave	III-a	1
<i>Njësia e Mbështetjes së Komisioneve</i>		
Specialist		
Sektori i Dokumentimit të Seancave	III-b	2
<i>Njësia e Mbështetjes së Komisioneve</i>		
Redaktor		
Sektori i Dokumentimit të Seancave	III-b	1
<i>Njësia e Mbështetjes së Komisioneve</i>		
Drejtor drejtorie	II-a	1
<i>Njësia e Shërbimeve të Përgjithshme Ligjore</i>		
Këshilltar	II-b	2
<i>Njësia e Shërbimeve të Përgjithshme Ligjore</i>		
Drejtor drejtorie	II-b	1
<i>Drejtoria Ekonomike dhe e Burimeve Njerëzore</i>		
Shef sektori	III-a	1
<i>Sektori i Burimeve Njerëzore dhe i Trajnimeve</i>		
<i>Drejtoria Ekonomike dhe e Burimeve Njerëzore</i>		

Specialist i Burimeve Njerëzore		
<i>Sektori i Burimeve Njerëzore dhe i Trajnimeve</i>	III-b	2
<i>Drejtoria Ekonomike dhe e Burimeve Njerëzore</i>		
Specialist Trajnimesh		
<i>Sektori i Burimeve Njerëzore dhe i Trajnimeve</i>	III-b	1
<i>Drejtoria Ekonomike dhe e Burimeve Njerëzore</i>		
Shef sektori		
<i>Sektori Ekonomik</i>	III-a	1
<i>Drejtoria Ekonomike dhe e Burimeve Njerëzore</i>		
Specialist Finance		
<i>Sektori Ekonomik</i>	III-b	2
<i>Drejtoria Ekonomike dhe e Burimeve Njerëzore</i>		
Drejtor drejtorie	II-b	1
<i>Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme</i>		
Shef sektori		
<i>Sektori i TIK, Digjitalizimit dhe Statistikës</i>	III-a	1
<i>Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme</i>		
Specialist IT		
<i>Sektori i TIK, Digjitalizimit dhe Statistikës</i>	III-b	2
<i>Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme</i>		
Shef sektori		
<i>Sektori i Shërbimeve Mbështetëse</i>	III-a	1
<i>Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme</i>		
Specialist për Marrëdhëniet me Publikun		
<i>Sektori i Shërbimeve Mbështetëse</i>	III-b	1
<i>Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme</i>		
Specialist Prokurimesh		
<i>Sektori i Shërbimeve Mbështetëse</i>	III-b	1
<i>Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme</i>		
Shoferi i Kryetarit		
<i>Sektori i Shërbimeve Mbështetëse</i>	Klasa VII	1

<i>Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme</i>		
Shofer		
<i>Sektori i Shërbimeve Mbështetëse</i>	Klasa VI	10
<i>Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme</i>		
Magaznier		
<i>Sektori i Shërbimeve Mbështetëse</i>	Klasa VI	1
<i>Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme</i>		
Punonjës Pastrimi		
<i>Sektori i Shërbimeve Mbështetëse</i>	Klasa III	1
<i>Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme</i>		
Shef sektori		
<i>Sektori i Shërbimit për Protokollin dhe Arkivën</i>	III-a	1
<i>Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme</i>		
Specialist Protokoli		
<i>Sektori i Shërbimit për Protokollin dhe Arkivën</i>	III-b	2
<i>Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme</i>		
Specialist Arkive		
<i>Sektori i Shërbimit për Protokollin dhe Arkivën</i>	III-b	1
<i>Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme</i>		
Totali		72

11. Procesi i rekrutimit të nëpunësve civilë.

Procedurat e rekrutimit të nëpunësve të KLP-së janë kryer sipas ligjit Nr.152/2013, “Për Nëpunësin Civil i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.242, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” i ndryshuar, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.243 datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar si dhe Ligjit Nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës” i ndryshuar.

Gjatë vitit 2023 janë kryer procedurat e rekrutimit si më poshtë vijon:

1. Numri i të rekrutuarve në shërbimin civil për periudhën Janar-Dhjetor 2023 është 17 (shtatëmbëdhjetë) dhe konkretisht:
 - a) 6 pozicione - Kategoria e nivelit të mesëm drejtues

- 3 pozicione konkurim me anë të ngritjes në detyrë:
 - a - në pozicionin Drejtor ekonomik dhe burimeve njerëzore;
 - b - 2 në pozicionin Këshilltar ligjor.
- 3 pozicione konkurimi pranin nga jashtë shërbimit civil:
 - a - 3 pozicione si Këshilltar ligjor
- b) 4 pozicione - Kategoria e nivelit të ulët drejtues
 - 3 pozicione konkurim me anë të ngritjes në detyrë:
 - a - Shef i sektorit të burimeve njerëzore dhe trajnimeve;
 - b - Shef i sektorit të shërbimeve për protokollin dhe arkivën;
 - c - Shef i sektorit TIK, Digjitalizimit dhe Statistikës.
 - 1 pozicion konkurimi pranin nga jashtë shërbimit civil:
 - a - Shef i sektorit të financës
- c) 7 pozicione - Kategoria e nivelit ekzekutive:
 - Konkurimi nëpërmjet pranimit nga jashtë shërbimit civil:
 - a - Specialist trajnimesh;
 - b - 2 Specialistë protokolli;
 - c - Specialist Prokurimesh;
 - ç - Specialist i dokumentimit të seancave;
 - d - Specialist redaktor
 - dh - Specialist IT
- 2. Numri i të rekrutuarve për punonjësit administrativë për periudhën Janar-Dhjetor 2023 është 3 (tre) dhe konkretisht:
 - a - 3 pozicione Shofer

12. Proceset gjyqësore.

Gjatë periudhës Janar 2023 – Dhjetor 2023, KLP-ja ka qenë e thirrur në cilësinë e palës së paditur në 28 procese gjyqësore të reja, dhe në cilësinë personit të tretë në 15 procese gjyqësore të reja, pa përfshirë proceset gjyqësore të bartura nga vitet e shkuara dhe të raportuara me raportet vjetore të mëparshme.

Në lidhje me shpërndarjen e proceseve të sipërcituara, 9 procese gjyqësore janë ndjekur në Gjykatën Administrative të Apelit dhe 34 procese të tjera janë ndjekur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë. KLP-ja ka ndjekur 2 procese në Gjykatën Kushtetuese dhe 2 procese në KPA.

Gjithashtu, për vitin e raportimit, KLP-ja ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj 3 vendimeve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë me objekt “Pagesë kalimtare”, por edhe ka ushtruar të drejtën e rekursit ndaj 3 vendimeve të Gjykatës Administrative të Apelit me objekte që lidhen me karrierën e prokurorit si: procedura e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele dhe instrumenti i caktimit të përkohshëm.

Së fundi, KLP-ja ka ushtruar edhe të drejtën e kundërrekursit ndaj 2 rekurseve të ushtruara kundër vendimeve të Gjykatës Administrative të Apelit me objekte që lidhen me karrierën e prokurorit si: pranimi në Formimin Fillestar në Shkollën e Magjistraturës dhe kundërshtimi i akteve normative nënligjore të Këshillit që lidhen me ngritjen në detyrë në pozicionin e prokurorit në SPAK.

Sikurse është raportuar gjatë vitit 2022, edhe gjatë vitit 2023 kanë vijuar proceset gjyqësore me objekt "Përfitim diference page/detyrim page", si rezultat i përlllogaritjes së gabuar të pagës së magjistratëve në Republikën e Shqipërisë, pavarësisht vendimit të Gjykatës Kushtetuese, e cila shfuqizoi nenin 12, pika 5, shkronja “a”, të ligjit për statusin, me nenin 2, pika 1, të ligjit Nr.50/2021, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe nenin 1, pika 7, paragrafi i dytë, shkronjat “a”, “b” dhe “c” të ligjit Nr.8097, datë 21.03.1996 “*Pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit*”, të ndryshuar me nenin 1, pika 1, të ligjit Nr.166/2020, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ku konfliktet gjyqësore u fokusuan gjithashtu edhe në fuqinë prapavepruese të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, sa i përket të drejtës për të përftuar pagën e re.

a. Çështje të juridiksionit fillestar në Gjykatën Administrative të Apelit.

KLP-ja ka në fokus dhe për kompetencë ligjore zhvillimin e karrierës së prokurorëve, ku ndër të tjera, gjatë vitit 2023, ka filluar procedurën e ngritjes në detyrë për 3 (tre) prokurorë të SPAK.

Gjatë konkurrimit, 8 (tetë) kandidatë shprehën interesin dhe aplikuan për t’u ngritur në detyrë si prokuror të SPAK. Pas miratimit të listës së kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore për ngritjen në detyrë, KLP-ja kualifikoi të gjithë kandidatët për të vijuar garën. Një prej kandidatëve, në momentin kur është njoftuar për relatorin përkatës dhe nëse ka ka shkaqe apo rrethana të mundshme konflikti të interesit në lidhje me secilin prej anëtarëve të Komisionit të Posaçëm dhe të Këshillit, ka kërkuar përjashtimin nga procedura e 2 anëtarëve të KLP-së. KLP-ja në mbledhje plenare, pasi mori në shqyrtim pretendimet e kandidatit, pretendimet e dy anëtarëve, përfundimisht vendosi refuzimin e kërkesës për përjashtimin nga vendimmarrja për procedurën e ngritjes në detyrën e prokurorit në SPAK të dy anëtarëve. Për këtë, kandidatja iu drejtua Gjykatës Administrative

të Apelit, me padi me objekt “konflikt interesi”. Ky proces pritet të përfundojë gjatë vitit 2024.

Gjithashtu, po në kuadër të procedurës së ngritjes në detyrë si prokuror në SPAK, po i njëjti kandidat, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me padi me objekt “paligjshmëri e rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar””. Gjykata Administrative e Apelit vendosi mospranimin e padisë, në kushtet kur mungonte legjitimiteti aktiv për ta kundërshtuar këtë akt normativ nënligjor. Lidhur me këtë padi, është kërkuar gjithashtu sigurimi i padisë, po kështu rrëzuar nga Gjykata Administrative e Apelit. Duke mos qenë dakord me këtë vendimmarrje, paditësja ka ushtruar të drejtën e rekursit të veçantë në Gjykatën e Lartë dhe KLP-ja e ka kundërshtuar nëpërmjet kundërrekursit të veçantë. Çështja pritet të shqyrtohet në Gjykatën e Lartë gjatë vitit 2024.

Gjatë vitit 2023, KLP-ja shpalli ndër të tjera, procedurën e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier. Për këtë pozicion shprehën interesin 6 (gjashtë) kandidatë. Në përfundim të procedurës, KLP-ja emëroi njërin prej kandidatëve në pozicionin e drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier. Një prej kandidatëve të tjerë, duke mos qenë dakord me vendimmarrjen e KLP-së, iu drejtua Gjykatës Administrative të Apelit me ankim. Gjykata Administrative e Apelit vendosi rrëzimin e kërkesëpadisë.

Po kështu, gjatë vitit të raportimit KLP-ja ka shpallur disa herë procedurën për transferim nëpërmjet lëvizjes paralele, në disa prokurori. Në tri raste, vendimmarrja e KLP-së është ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit, përkatësisht për një pozicion në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe dy pozicione Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Për dy raste, Gjykata Administrative e Apelit vendosi pranimin e kërkesëpadive dhe për një rast vendosi pushimin e gjykimit të çështjes me kërkesë të paditësit. Ndaj vendimeve të Gjykatës Administrative të Apelit, KLP-ja ka ushtruar të drejtën e rekursit në Gjykatën e Lartë, si dhe ka depozituar kërkesë për pezullim të ekzekutimit të vendimit. Këto çështje priten të shqyrtohen gjatë vitit 2024.

Edhe për instrumentin e caktimit të përkohshëm, ka patur gjithashtu një konflikt gjyqësor në Gjykatën Administrative të Apelit, për të cilin gjykata vendosi pranimin e pjeshëm të kërkesëpadisë. Për këtë, KLP-ja ka ushtruar të drejtën e rekursit dhe çështja pritet të shqyrtohet gjatë vitit 2024.

Gjithashtu, një prej detyrave të caktuara nga Ligji për Statusin për KLP-në, është verifikimi i pasurisë dhe figurës për kandidatët që konkurrojnë për t’u pranuar në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, profili prokuror.

Gjatë procesit të verifikimit, në vitin 2022, KLP-ja ka marrë një vendim ndalimi për pranimin e kandidatëve në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2022-2023. Kandidati iu drejtua Gjykatës Administrative të Apelit, e cila vendosi rrëzimin e kërkesëpadisë. Padiësi më pas ka ushtruar të drejtën e rekursit ndaj këtij vendimi në Gjykatën e Lartë dhe KLP-ja ka ushtruar të drejtën e kundërrekursit ndaj rekursit të ushtruar nga padiësi. Kjo çështje pritet të shqyrtohet gjatë vitit 2024.

b. Çështje në Gjykatën e Lartë.

Për periudhën e raportimit, nga ana e Gjykatës së Lartë janë shqyrtuar dy rekurse të veçanta, nga ana e një prokurori dhe ish-prokurori, për të cilat Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e tyre. Pritet që gjatë vitit 2024, të shqyrtohen një sërë rekursesh/kundërrekursesh dhe dy kërkesa për pezullim të depozituara nga palët në procesin administrativ, pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

c. Çështje në KPA dhe në Gjykatën Kushtetuese.

Gjatë vitit 2023, pranë KPA janë marrë në shqyrtim dy ankime prokurorësh, ndaj vendimeve të KLP-së për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, për të cilat KLP-ja ka paraqitur prapësimet dhe provat përkatëse. KPA-ja ka vendosur mospranimin e ankimit kundër vendimeve të KLP-së për caktimin e masës disiplinore, duke mbajtur kështu të njëjtin qëndrim me KLP-në për rastet e shqyrtuara.

Gjithashtu, pranë Gjykatës Kushtetuese është shqyrtuar çështja me kërkues Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit, me objekt shfuqizimin si i papajtueshëm me Kushtetutën të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.495, datë 21.07.2022, “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”, për të cilat KLP-ja ka paraqitur prapësimet dhe provat përkatëse si subjekt i interesuar. Në përfundim të gjykimit, Gjykata Kushtetuese vendosi rrëzimin e kërkesës së Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë dhe Komitetit Shqiptar të Helsinkit.

Në Gjykatën Kushtetuese është shqyrtuar gjithashtu një çështje, ku kërkues ishte një kandidat që ishte ndaluar nga KLP-ja për t’u pranuar në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, i cili pasi ushtroi të drejtën e rekursit dhe Gjykata e Lartë vendosi mospranimin e tij, iu drejtua Gjykatës Kushtetuese. Për këtë kërkesë, KLP-ja ka paraqitur prapësimet dhe provat përkatëse si subjekt i interesuar. Në përfundim të gjykimit, Gjykata Kushtetuese vendosi rrëzimin e saj.

G. VEPRIMTARIA E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME DHE KOMISIONEVE TË TJERA TË KËSHILLIT.

Komisionet e Përhershme.

Përbërja e katër komisioneve të përhershme të Këshillit ka ndryshuar në muajin dhjetor 2023, për shkak të përtëritjes së pjesshme të përbërjes së anëtarëve të KLP-së, në përputhje me ligjin.

13. Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Në zbatim të detyrimeve që burojnë nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Ligji për Statusin, Ligji për Qeverisjen, Komisioni i Buxhetit ka ushtruar veprimtarinë e tij në përputhje me nenin 40, të Rregullores “*Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë*”.

Veprimtaria e Komisionit është realizuar në drejtimet e mëposhtme:

- a) Hartimi dhe monitorimi i zbatimit të planit strategjik, në përputhje me objektivat e ligjit për qeverisjen dhe koordinimin me strategjinë e sektorit të drejtësisë;
 - b) Mirëorganizimi i fondeve buxhetore për vitin 2023;
 - c) Miratimi i kërkesave buxhetore për vitin 2024-2026;
 - d) Aktet nënligjore me karakter financiar në zbatim të ligjit Nr.96/2016, i ndryshuar;
 - e) Miratimi i strukturës organizative të administratës së Këshillit;
 - f) Veprimtaritë jashtë funksioni;
 - g) Veprimtaria lidhur me deklarin e mbarimit të mandatit të anëtarëve për të cilët është plotësuar afati ligjor 5-vjeçar;
 - h) Miratimi i akteve nënligjore.
- a. Hartimi dhe monitorimi i zbatimit të planit strategjik, në përputhje me objektivat e ligjit për qeverisjen dhe koordinimin me strategjinë e sektorit të drejtësisë**

Këshilli ka hartuar Planin Strategjik² të veprimtarisë e tij që mbulon periudhën e viteve 2021-2024, i cili është miratuar me vendimin Nr.317, datë 29.12.2020³. Aktualisht, Këshilli ndodhet në vitin e katërt dhe të fundit të zbatimit të këtij plani. Monitorimi i zbatimit të këtij plani strategjik shërben jo vetëm për marrjen e masave të duhura për realizimin e atyre objektivave që nuk janë realizuar apo që po realizohen jashtë afateve të planifikuara por edhe për faktin që, Këshilli gjatë

² <https://keshilli.al/ep-content/uploads/2021/01/Plani-Strategjik-2021-2024.pdf>


³ <https://keshilli.al/ep-content/uploads/2020/12/Vendim-nr-317-29.12.2020.pdf.pdf.pdf.pdf>

vitet 2024, duhet të marrë masat për hartimin e planit të ri strategjik që do të zbatohet nga viti 2025 dhe në vazhdim.

b. Mirëorganizimi i fondeve buxhetore për vitin 2023.

Gjatë vitit 2023, Këshilli në vijim edhe të punës së Komisionit ka pasur një realizim pozitiv të treguesve të performancës buxhetore të pasqyruar në grafikun dhe tabelën e mëposhtme:

Realizimi buxhetor në mënyrë grafike:



Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur në vlera të dhënat e realizimit të buxhetit për periudhën Janar- Dhjetor 2023.

000/mijë lek

NR.	ZËRAT E SHPENZIMEVE	JANAR - DHJETOR 2023		
		PLAN i rishikuar	FAKT	REALIZIMI %
1	PAGA	138,213	138,093	99,9%
2	SIGURIME SHOQËRORE	15,941	15,633	98%
3	MALLRA DHE SHËRBIME	33,431	33,155	99%
4	INVESTIME	15,000	13,924	93%

Nga pasqyra e mësipërme rezulton se, buxheti për periudhën janar-dhjetor 2023 është realizuar në masën 99%, i ndarë si më poshtë:

1. Paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore (600+601) **realizuar 99,9%**.

2. Shpenzimet operative (602) **realizuar 99%**. Realizimi i këtij zëri vjen si rezultat i kompletimit të stafit administrativ, duke ndikuar në realizimin e procedurave të prokurimit për mallra dhe shërbime të nevojshme për mirëfunksionimin e institucionit.
3. Investimet publike (231) janë **realizuar 93%** e fondit të planifikuar, në zërat si më poshtë vijon:
 - Blerje automjeti për Anëtarët e Këshillit;
 - Blerje pajisje TIK;
 - Rikonstruksion, ndarje funksionale zyre;
 - Blerje sistem konference.

Siç mund të konstatohet, realizimi i fondeve buxhetore është realizuar në masë **shumë të mirë**, duke treguar se ka mirë-funksionuar planifikimi që Komisioni ka parashikuar në kërkesat e tij.

c. Miratimin e kërkesave buxhetore për vitin 2023-2025.

Në zbatim të Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimit Nr.7, datë 28.02. 2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, të Udhëzimit plotësues Nr.9 , datë 08.02.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”, të Ministrit të Financave si dhe Vendimit Nr.195, datë 05.04.2023 “Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026”, të Këshillit të Ministrave, Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit ka punuar për përgatitjen e buxhetit të vitit 2024-2026 dhe hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm të Këshillit për periudhën 2024-2026. Ky plan i është dërguar Ministrisë së Financave me shkresën Nr.985/1 Prot, datë 08.05.2023.

Me Vendimin Nr.90, Këshilli ka miratuar kërkesat buxhetore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026.

Nga Ministria e Financës nuk janë marrë në konsideratë kërkesat për ndryshime, pasi në miratimin e tavanëve me Vendimin Nr.436, datë 19.07.2023 për “Miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026”, e Këshillit të Ministrave, buxheti reflekton tavanë më të vogla nga ato të propozuara.

Më datë 07.11.2023, është parashtruar përpara Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtave të Njeriut në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, kërkesat buxhetore për PBA, për periudhën 2024-2026.

Për sa më sipër, kërkesat për shpenzimet buxhetore të PBA për vitet 2024-2026 janë pranuar pjesërisht nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut pranë Kuvendit, i cili ka miratuar numrin prej 72 punonjës.

Për vitin 2024, fondi i pagave (600) është 155,000,000 lekë dhe fondi për kontributet e sigurimeve shoqërore (601) është 18,600,000 lekë.

Këshilli nuk gjeneron të ardhura të tjera përveç atyre që akordohen nga buxheti i shtetit.

PBA e miratuar sipas VKM Nr.436, datë 19.07.2023

Viti		2026	2025	2024
	Nr.punonjësve	72	72	72
Llog	600+601	132,517,000	132,517,000	132,517,000
Llog	602	27,983,000	27,483,000	25,483,000
Llog	231	10,000,000	10,000,000	10,000,000
Total		170,500,000	170,000,000	168,000,000

PBA e propozuar sipas Vendimit të Këshillit Nr.90, datë 02.05.2023 :

Viti		2026	2025	2024
	Nr.punonjësve	72	72	72
Llog	600+601	144,407,000	144,407,000	144,407,000
Llog	602	35,000,000	35,000,000	35,000,000
Llog	231	10,000,000	10,000,000	10,000,000
Total		189,407,000	189,407,000	189,407,000

Tavanet e miratuara sipas ligjit 97/2023 për “Buxhetin e vitit 2024 :

Viti		2026	2025	2024
	Nr.punonjësve	72	72	72
Llog	600+601	179,110,000	179,110,000	173,600,000
Llog	602	26,483,000	25,483,000	30,483,000
Llog	231	10,000,000	10,000,000	10,000,000
Total		215,593,000	214,593,000	214,083,000

d. Aktet nënligjore me karakter financiar në zbatim të Ligjit për Statusin.

Me Vendimin Nr.35, datë 22.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese është vendosur shfuqizimi i nenit 12, pika 5, shkronja “a”, të Ligjit për Statusin me nenin 2, pika 1, të ligjit Nr.50/2021, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë si dhe nenit 1, pika 7, paragrafi i dytë, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të ligjit Nr.8097, datë 21.3.1996, “*Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit*”, të ndryshuar me nenin 1, pika 1, të ligjit Nr.166/2020, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Për rrjedhojë, në zbatim të Vendimit Nr.35, a 22.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese”, Këshilli ka bërë përllogaritjen e “pagës referuese bazë” sipas kategorisë 1-b, përfshirë “shtesën për pozicion” dhe “pagën e grupit” sipas grupit 1 të diplomave universitare për periudhën 01.01.2019-31.12.2022 dhe marrjen e masave për mbulimin e efekteve financiare të krijuara si pasojë e diferencës së shkaktuar në buxhetin e vitit 2023 për fondin “Paga”.

e. Miratimi i strukturës organizative të administratës së Këshillit.

Gjatë shqyrtimit të projektbuxhetit për vitin 2023, kërkesa e Këshillit për shtesë në numrin e punonjësve në organikë është pranuar pjesërisht dhe Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar organikën prej gjithsej **72 punonjës**.

Duke pasur në konsideratë detyrimet organizative dhe strukturore të parashikuara në nenin 178, të Ligjit për Qeverisjen, si dhe miratimin e rritjes së numrit të personelit, Këshilli, me Vendimin Nr.21, datë 16.01.2023 “*Për fillimin e procedurave të ristrukturimit të administratës së KLP-së*” ka zhvilluar procedurat e ristrukturimit të administratës së tij.

Ristrukturimi ka pasur në konsideratë:

- a.** plotësimin e detyrimit ligjor të parashikuar nga neni 178, pika 1, e Ligjit për Qeverisjen;
- b.** që numri i punonjësve të KLP-së për vitin 2023 është 72 referuar Tabelës Nr.2 të ligjit Nr.84/2022 “*Për buxhetin e vitit 2023*”;
- c.** që për KLP-në për vitin 2023 fondi i pagave (600) është 117,076,000 lekë dhe fondi për kontributet e sigurimeve shoqërore (601) është 15,441,000 lekë;
- d.** mundësinë për sistemimin e çdo nëpunësi civil ekzistuese në vendet e reja që do të krijohen.

Në përfundim, Komisioni i Buxhetit, bazuar mbi relacionin e përgatitur nga Komisioni i Ristrukturimit, ka paraqitur propozimin për miratimin e organikës së

re të Këshillit, e cila është miratuar me Vendimin e Këshillit Nr.73, datë 24.04.2023. Efektet financiare të këtij ristrukturimi do të respektojnë tavanin buxhetor të miratuar me ligjin Nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”.

f. Miratimin e kërkesave për lejimin e veprimtarive jashtë funksionit për prokurorët.

Gjatë vitit 2023, Komisioni i Buxhetit, ka shqyrtuar **16 (gjashtëmbëdhjetë) kërkesa për veprimtari jashtë funksioni** të magjistratëve, prej të cilave **Këshilli ka miratuar 15 (pesëmbëdhjetë) kërkesa**

Veprimtaritë jashtë funksionit të kryera nga prokurorët i përkasin kryesisht fushave si, e drejtë penale (pjesa e përgjithshme/posaçme) apo procedurë penale, hetimi apo gjykimi i veprave penale për trafikimin e qenieve njerëzore, krimi kibernetik, liria e shprehjes dhe e medias, legjislacioni mjedisor dhe mbrojtja e mjedisit, çështje të dhunës me bazë gjinore dhe dhuna në familje, të miturit, tema lidhur me tatimet dhe fushën fiskale, etj.

Institucionet ku prokurorët kanë ushtruar veprimtarinë jashtë funksionit janë institucione ndërkombëtare apo kombëtare, të arsimit të lartë publike ose jo publike dhe organizata të shoqërisë civile si, Zyra për Drogën dhe Krimin e Kombeve të Bashkuara (UNODC), OSBE, projekti JUSTAL i Bashkimit Europian, Shkolla e Magjistraturës, Universiteti EPOKA, “Albanian University”, Tiranë, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore, OJF “Qendra për Nisma Ligjore”, Tiranë, etj.

Magjistratët prokurorë kanë ushtruar këto veprimtari në cilësinë si udhëheqës shkencor, lehtësues, pedagogë ose lektorë të jashtëm për leksione dhe seminare, ekspertë, trajnerë, etj., pranë institucioneve dhe subjekteve të mësipërme. Periudha e ushtrimit të këtyre veprimtarive është e shtrirë në vitin akademik 2022-2023.

Angazhimet e mësipërme i shërbejnë zhvillimit të mëtejshëm profesional, cilësisë si dhe rritjes së aftësive për tematika të ndryshme të së drejtës në përgjithësi.

g. Deklarimi i mbarimit të mandatit të anëtarëve të këshillit për të cilët është plotësuar afati ligjor 5-vjeçar.

Në përputhje me sa parashikon neni 101, pika 4, i Ligjit për Qeverisjen, anëtari i Këshillit qëndron në detyrë për 5 vjet, përveç rasteve kur vërtetohen kushtet për ndërprerjen e parakohshme të mandatit.

Në muajin Dhjetor 2023, për 3 (tre) anëtarë që vinin nga radhët e prokurorëve, Këshilli ka deklaruar mbarimin e mandatit të tyre për shkak të plotësimit të afatit 5-vjeçar në datën 18.12.2023.

Ata janë zëvendësuar nga 3 (tre) anëtarët e rinj të cilët janë zgjedhur me votim nga Asambleja e Përgjithshme e Prokurorëve.

Gjithashtu, 3 (tre) anëtarë të tjerë të Këshillit (*anëtarët që vijnë nga radhët e avokatisë dhe shoqërisë civile*) kanë plotësuar mandatin ligjor 5-vjeçar në datën 18.12.2023. Aktualisht, po zhvillohet procedura ligjore për zëvendësimin e tyre në përputhje me nenet 152 dhe vijues të Ligjit për Qeverisjen.

h. Miratimi i akteve nënligjore.

Gjatë vitit 2023, Këshilli ka vijuar punën për miratimin e akteve nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e tij në përputhje me detyrimet që burojnë nga legjislacioni përkatës, Ligji për Statusin, Ligji për Qeverisjen dhe Ligjin për Prokurorinë.

Gjatë vitit 2023, Këshilli ka miratuar aktet nënligjore si vijon:

1. Rregullorja “*Për përcaktimin e rregullave dhe arsyeve të lejimit të kandidatit për magistrat për t’u emëruar në vitin pasardhës*”;
2. Rregullorja “*Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë prokurorisë së posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar*”;
3. Rregullorja “*Për caktimin e rregullave dhe procedurave mbi uljen e ngarkesës së punës për prokurorët*”;
4. Rregullorja “*Mbi dhënien e lejes së papaguar*”
5. Rregullore “*Për vlerësimin etik dhe profesional të drejtuesve të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm*”;
6. Rregullore “*Për caktimin e procedurës dhe masës së trajtimit financiar të prokurorit për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm, për caktimin e përkohshëm dhe caktimin për një çështje të veçantë*”;
7. Rregullore “*Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë*”.
8. Rregulloren “*Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar*”

Po ashtu, nga komisionet e përhershme dhe grupet e punës vijon puna për hartimin e akteve nënligjore si vijon:

1. Rregullorja “Për kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e magistratëve në skemën e delegimit”;
2. Rregullorja “Për përmbajtjen e programeve të formimit vazhdues, shërbimet lehtësuese të lejuara, si dhe për procedurën e pajisjes me leje për ndjekjen e trajnimeve”;
3. Rregullorja “Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme”;
4. Rregullorja për “Përcaktimin e normës vjetore të ngarkesës në punë të prokurorëve”.
5. Rregullorja “Për procedurën e emërimit të Sekretarit të Përgjithshëm të Prokurorisë së Përgjithshme”;
6. Rregullorja “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të rekrutimit, të drejtave dhe detyrimeve, transferimit, pezullimit, disiplinës dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës të kancelarëve të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe këshilltarëve ligjorë jomagjistratë të Prokurorisë së Përgjithshme”;
7. Rregullorja “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit të sistemit të prokurorisë”;
8. Aktet nënligjore lidhur me statusin e nëpunësve civilë të prokurorisë sipas Ligjit Nr.97/2016, i ndryshuar;
9. Rregullore të përbashkëta me KLGJ-në;
 - Për bashkimin e procedimeve disiplinore.
 - Për caktimin e gjykatave, prokurorive dhe magistratëve udhëheqës për programin e praktikës profesionale, vlerësimin etik, profesional si dhe cilësisë së kandidatëve magistratë.

14. Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale

a. Vlerësimi etik dhe profesional i prokurorëve.

Viti 2023 ka qenë një vit intensiv pune dhe sfide në drejtim të procesit të vlerësimit etik dhe profesional të prokurorëve, si një nga detyrat kryesore të veprimtarisë së tij, mbështetur në nenin 149/a, pika 1, germa “a”, të Kushtetutës.

Qëllimi i këtij vlerësimi është përmirësimi i vazhdueshëm i etikës dhe aftësive profesionale të prokurorit, zhvillimi i karrierës mbi bazën e meritës, identifikimi

më mirë i nevojave për kualifikimin e mëtejshëm, si dhe përmirësimi i efikasitetit të zyrtarëve të prokurorisë.

Me vendimin Nr.313, datë 30.11.2022, Këshilli vendosi të miratojë programin që përcakton listën e prokurorëve, për të cilët do të kryhet vlerësimi etik dhe profesional individual përgjatë vitit 2023.

Bazuar në këtë vendim Këshilli duhet të kryejë vlerësimin etik dhe profesional për 155 prokurorë.

Në hartimin e listës së prokurorëve për të cilët filloi procedura e vlerësimit përgjatë vitit 2023, është mbajtur në konsideratë neni 84 i Ligjit për Statusin, lidhur me periudhën individuale të vlerësimit, specifikisht:

- a) *Magjistrati prokuror vlerësohet një herë në tre vjet, gjatë 15 viteve të para të përvojës profesionale, përfshirë edhe përvojën profesionale si ndihmësmagjistrat ose magjistrat i komanduar;*
- b) *Magjistrati prokuror vlerësohet një herë në pesë vjet, pas 15 viteve të para të përvojës profesionale si magjistrat.*

Gjatë këtij procesit të vlerësimit janë hasur vështirësi në plotësimin e tabelave, sipas anekseve të Rregullores së Vlerësimit nga prokuroritë në të cilat kanë ushtruar funksionin, prokurorët e shortuar për vlerësim. Ky ngërç ka sjellë dhe vonesa në kryerjen në afat të këtij procesi.

Konkretisht, **Aneksi Nr.1**, i Rregullores, “*Metodologjia e pikëzimit*”, ka për qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të prokurorit, për secilin kriter dhe treguesit përkatës ligjorë, mbi bazën e një sistemi pikësh, të përcaktuar mbi meritat e prokurorit, kualifikimin, integritetin, aftësinë dhe efikasitetin e tij, duke respektuar parimin e pavarësisë së prokurorit.

Aneksi Nr.2, i Rregullores ka miratuar modelin e tabelave statistikore me të dhënat për secilin prokuror që do të vlerësohet, si dhe të dhënat mesatare për seksionet apo të gjithë Prokurorinë ku ka ushtruar detyrën prokurori i cili vlerësohet. Plotësimi i tabelave statistikore të miratuara në Aneksin Nr.2, sipas përcaktimeve të Ligjit për Statusin dhe Rregullores së Vlerësimit ka hasur vështirësi teknike për shkak të integritetit të disa të dhënave referuese, të cilat nuk ishin parashikuar më parë në regjistrat fizikë dhe elektronikë që plotësonin zyrat e Prokurorisë për efekt statistikash.

Në takimet e zhvilluara me Prokurorin e Përgjithshëm është trajtuar problematika e hasur dhe mundësia e bashkëpunimit në plotësimin e regjistrave fizikë statistikore me të dhënat që kërkohen për procesin e vlerësimit etiko-profesional të prokurorëve, si dhe nevojën e krijimit të një sistemi të unifikuar elektronik të të dhënave statistikore. Për kryerjen e vlerësimit të magjistratit prokuror nevojiten të dhëna statistikore nga prokuroria ku magjistrati që vlerësohet ka ushtruar detyrën.

Plotësimi i një pjesë të dhënave statistikore në rrugë manuale solli vonesa në ecurinë e hedhjes së shortit të dosjeve që do të vlerësohen si pjesë e procesit të mëtejshëm.

Mbështetur në nenin 171, pika 8, të Ligjit për Statusin, përcaktohet se: “...Të dhënat statistikore përpunohen nga gjykata ose prokuroria ku ushtron detyrën magjistrati që do të vlerësohet, si dhe dërgohen nga kryetari të Këshilli përkatës, deri në momentin që Këshillat kanë akses të drejtpërdrejtë në të dhënat e sakta dhe të sigurta statistikore në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve në gjykata dhe në prokurori. Të dhënat statistikore për magjistratin që është në proces vlerësimi i dërgohen Këshillit respektiv nga kryetari i gjykatës ose i prokurorisë, në të cilën magjistrati ka ushtruar detyrën gjatë periudhës për të cilën kryhet vlerësimi. Këshilli përcakton, **me vendim**, kohën dhe procedurat e marrjes drejtpërdrejt të të dhënave statistikore nga sistemi...”.

Gjatë vitit 2023, Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale përfundoi me sukses procedurat e shortit në të gjithë Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm për të gjithë prokurorët si subjekt vlerësimi të shortuar nga Këshilli.

Procesi i shortimit u mbështet në nenin 91, të Ligjit për Statusin dhe konkretisht:

“...Për vlerësimin etik dhe profesional të veprimtarisë së magjistratit u përzgjedhën me short jo më shumë se 21 çështje të përfunduara nga magjistrati në periudhën për të cilën bëhet vlerësimi. Për vlerësimin e përgjithshëm u përzgjedhën 15 dosje, nga të cilat 5 (pesë) dosje për çdo vit kalendarik të periudhës për të cilën bëhet vlerësimi, në rast të vlerësimit për një periudhë trevjeçare, dhe 3 (tri) dosje për çdo vit kalendarik, në rast të vlerësimit për një periudhë pesëvjeçare. Pjesa tjetër e dosjeve u përzgjidh sipas kriterit të vonesës në afate, nga të cilat 5 % (për qind), por jo më shumë se 6 (gjashtë) çështje nga numri i përgjithshëm, u vendosën përtej afateve standarde.

Relatorët përcaktuan dhomën dhe seksionin ku magjistrati kish ushtruar funksionin në periudhën për të cilën bëhet vlerësimi dhe, në varësi të numrit të çështjeve për çdo kategori, përcaktuan me aktet “Urdhër” dhe “Vendim” numrin e çështjeve që do të përzgjidheshin në mënyrë të barabartë për secilën kategori, duke përfshirë domosdoshmërisht çështjet penale që lidhen me veprat penale të parashikuara në kreun X, të Kodit Penal, për të cilat parashikohet dënimi në minimum jo më pak se 1 (një) vit burgim, nëse magjistrati kishte hetuar/gjykuar çështje të kësaj natyre gjatë periudhës së vlerësimit.

Për zhvillimin e procedurave të vlerësimit etik dhe profesional legjislativi në fuqi dhe rregullorja përkatëse parashikon caktimin me short këshilltarin përgjegjës për çdo vlerësim.

Këshilltari për vlerësimin është prokurori i komanduar pranë Këshillit, pjesë e Njësisë së Mbështetjes së Komisioneve, i cili është përgjegjës, për mbledhjen e

dokumentacionit dhe krijimin e dosjes së vlerësimit, hartimin e raportit analitik; si dhe çdo detyrë tjetër të caktuar në ligj dhe në këtë rregullore.

Gjatë vitit 2023 përfundoi afati i komandimit të prokurorëve të cilit ishin komanduar në Këshill në pozicionin e këshilltarit ligjor përgjegjës për procesin e vlerësimit.

Këshilli zhvilloi procedurat dhe realizoi komandimin e 5 (pesë) prokurorëve të tjerë në këtë detyrë dhe u përsëritën edhe një herë procedurat për hedhjen e shortit për caktimin e Këshilltarit për vlerësimin në radhët e prokurorëve të komanduar rishtas.

-Vlerësime etike profesionale të pezulluara dhe të ndërprera pa vendim përfundimtar gjatë vitit 2023.

Gjatë vitit 2023 janë pezulluar 2 (dy) procedura vlerësimi pasi një nga subjektet është shkarkuar nga detyra nga K.P.K-ja ndërsa një subjekt tjetër është zgjedhur anëtar Këshilli,

Gjithashtu Këshilli ka ndërprerë pa vendim përfundimtar procedurën e vlerësimit për një prokuror për shkak të mbarimit të statusit si magjistrat.

-Vlerësime etike profesionale me procedurë të përshpejtuar.

Në kuadër të procedurave të lëvizjes paralele janë paraqitur 9 (nëntë) kërkesa për vlerësim të përshpejtuar, për 2 (dy) nga këto kërkesa janë zhvilluar të gjitha procedurat dhe aktualisht janë në fazën përfundimtare të vlerësimit. Kërkesa të tjera janë refuzuar mbi bazën e vendimeve të arsyetuar të Këshillit.

- Programi i vlerësimit etik dhe profesional për vitin 2024.

Bazuar në nenin 85, të Ligjit për Statusin, Këshilli, miratoi programin që përcakton listën e magjistratëve, për të cilët do të kryhet vlerësimi përgjatë vitit përkatës dhe periudhën e vlerësimit. Ky program u materializohet nëpërmjet identifikimit dhe listimit të të gjithë atyre prokurorëve për të cilët, ligji mbart detyrimin e kryerjes së vlerësimit etik dhe profesional për vitin 2024 përfshirë këtu dhe periudhën e vlerësimit individual.

Duke pasur si referencë vitin 2016, vit kur është bërë vlerësimi i fundit për prokurorët, Këshilli do të kryejë procedurën e vlerësimit të magjistratëve prokurorë për gjatë vitit 2024 dhe periudha e vlerësimit do të jetë nga 1 Janar 2017 - 31 Dhjetor 2019 për vlerësimin 3-vjeçar dhe 1 Janar 2017 - 31 Dhjetor 2021 për vlerësimin 5-vjeçar, në varësi të vjetërsisë në punë të magjistratit.

Pjesë e programit për vlerësim do jenë të gjithë magjistratët prokurorë të Republikës së Shqipërisë, të cilët janë aktiv në sistem përveç atyre që janë aktualisht në proces vlerësimi etik dhe profesional periodik dhe në vlerësim etik profesional me procedurë të përshpejtuar, si dhe prokurorëve që nuk kanë mbushur

tre vjet punë. Si më sipër listën e programit përfundimtar për tu vlerësuar rezultuan 156 prokurorë.

Për të garantuar një sistem të drejtë dhe të paanshëm vlerësimi kundrejt një numri relativisht të madh prokurorësh për shkak se procesi i vlerësimit po zhvillohet në kushte funksionaliteti të vështira përse i përket raportit të numrit të nevojave për vlerësime dhe kapaciteteve njerëzore që aktualisht po punojnë intesivisht në kuadër të këtij procesi, Komisioni vlerësoi që në planifikimin e vlerësimeve individuale të aplikoheshin disa filtrave selektivë ligjor me qëllim përcaktimin e një liste të arsyeshme të prokurorëve për të cilët mund të realizohet një proces vlerësimi i plotë dhe cilësor përgjatë vitit 2024.

Mbi bazë të këtij arsytimi, në planifikimin e vlerësimeve individuale, referuar edhe parashikimeve të nenit 16 të Rregullores (duke pasur parasysh dhe ndryshimet, p.sh miratimi i Rregullores për vlerësimin e të komanduarve etj), Komisioni përjashtoi nga kjo listë prokurorët në bazë të parashikimeve të nenit 3 të Rregullores për Vlerësimin, kategoritë e subjekteve si më poshtë:

- Anëtarë prokurorë të Këshillit, për kohën që janë duke ushtruar këtë funksion dhe anëtarët e rinj prokurorë të zgjedhur aktualisht;
- Prokurorët e komanduar në struktura të tjera, të ndryshme nga ato të përcaktuara më sipër, por që gëzojnë statusin e magjistratit. Veprimtaria e tyre, sipas ligjit, vlerësohet nga vetë institucioni, referuar sistemit të vlerësimit të strukturës përkatëse, ku janë komanduar.
- Prokurorët në prag pensioni (mbahet parasysh parasysh mosha 62 vjeç e sipër, pra, duke i përjashtuar nga vlerësimi i pesë vjeçarit të fundit).
- Prokurorët e Prokurorisë pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, për shkak të ngarkesës specifike që ata kanë aktualisht e njëkohësisht duke mbajtur në konsideratë faktin se për njërin prej prokurorëve të kësaj strukture i cili aktualisht është në proces vlerësimi është hasur problematike edhe sa i takon shortimit, por edhe administrimit në kohë të fashikujve të përzgjedhur (kjo, sepse në ndryshim nga prokurorët e tjerë në proces vlerësimi, për prokurorët e kësaj strukture një pjesë fashikujve, të shortuar ndiqen gjatë fazës së gjykimit nga prokurorë të tjerë e po ashtu duhet të kihet parasysh se kanë një natyrë specifike në lidhje me rëndësinë dhe anonimitetin.) Mbi të gjitha, është zgjedhur të përjashtohen për momentin prokurorët e kësaj strukture, për të mundësuar *garantimin e funksionimit të Prokurorisë së Posaçme, si një prokurori e specializuar, për të ushtruar kompetencat e parashikuara në pikën 1, të nenit 148/dh, të Kushtetutës, në mënyrë efikase dhe të pavarur nga çdo ndikim i paligjshëm, i brendshëm apo i jashtëm..., si qëllim parësor të kësaj Prokurorie.*

Referuar sa më sipër në listën për vlerësim përgjatë vitit 2024, rezultuan 110 prokurorë. Komisioni vendosi që shorti të hidhej për **40 prokurorë me ndarjet si më poshtë:**

- 6 Drejtues të Prokurorive, që mbushin 3 vjet punë në vitin 2024 do të futen automatikisht në procedurë vlerësimi;
- 1 (një) prokuror nga Prokuroria e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm;
- 33 (tridhjetë e tre) prokurorë nga Prokuroritë e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Për faktin që komisionet e përhershme të Këshillit do të riformatoheshin pas datës 18 dhjetor 2023, Komisioni vlerësoi që shortet për përzgjedhjen e emrave të prokurorëve, relatorëve dhe këshilltareve ligjorë përgjegjës për vlerësimin të hidhen pasi të ishte përfunduar ky proces.

Në përfundim, bazuar në nenet 84 dhe 85, të Ligjit për Statusin, dhe Rregullores për Vlerësimin, me propozim të Komisionit, Këshilli miratoi programin që përcakton listën prej 40 (dyzetë) prokurorë, për të cilët do të kryhet vlerësimi etik dhe profesional përgjatë vitit 2024.

b. Raporte të vlerësimit të aftësive profesionale të prokurorëve.

Komisioni, mbështetur në nenin 160, pika 2, germa “d”, të Ligjit për Statusin, kryen vlerësimin e punës, siç parashikohet në dispozitën kalimtare të këtij ligji, duke përfshirë edhe ndihmën në rivlerësimin kalimtar të prokurorëve, në mbështetje të Ligjit Nr.84/2016 “*Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, duke kontribuar në përgatitjen e Raporteve individuale të prokurorëve.

Në përgatitjen e raporteve për analizimin e aftësive profesionale të prokurorëve subjekte të rivlerësimit kalimtar, Komisioni është ndihmuar nga 5 (pesë) prokurorë të sistemit të prokurorisë, të cilët janë komanduar për një periudhë pesë-vjeçare pranë Këshillit.

Këto raporte janë hartuar nga prokurorët e komanduar në bashkëpunim me anëtarët e Komisionit, duke u mbështetur në kriteret e përcaktuara si, aftësitë profesionale, aftësitë organizative, etika dhe angazhimi në veprimtari profesionale, si dhe duke u bazuar në gjetjet në aktet e administruara, për analizimin e aftësive profesionale.

Në të gjitha rastet, kur janë konstatuar gjetje, ato janë evidentuar në pjesën e raportit që analizon dokumentet ose dosjet. Raporti i vlerësimit të aftësive profesionale në kuadër të procesit të rivlerësimit, konkludon nëse subjekti i rivlerësimit arrin një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, standard i mjaftueshëm për konfirmimin në detyrë sipas germës “c”,

të pikës 1, të nenit 59 të ligjit Nr.84 të vitit 2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në asnjë rast, organet e vettingut nuk kanë adresuar në Këshill, problematika mbi cilësinë e raporteve të aftësive profesionale, në kuadër të procesit të rivlerësimit.

Në përfundim, janë përgatitur dhe janë miratuar në seancë plenare nga Këshilli, për gjatë vitit 2023, gjithsej 45 (dyzet e pesë) Raporte për subjekte magjistratë (prokurorë), që janë vënë në dispozicion të KPK-së dhe ONM-së.

-Një veprimtari tjetër e rëndësishme më karakter periodik e këtij komisioni është edhe verifikimi i pasurisë dhe figurës, për kandidatët që u pranuan në Formimin Fillestar të Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik 2023-2024

Këshilli miratoi vendimin Nr.25, datë 30.01.2023, me të cilin vendosi që numri maksimal i kandidatëve për magjistratë të profilit prokuror që do të pranoheshin në programin e formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës të jetë 40 (dyzetë) kuota.

Për vitin akademik 2023-2024 u pranuan sipas kuotave të Shkollës së Magjistraturës 26 (njëzet e gjashtë) kandidatë për profilin prokuror.

Mbështetur në nenin 32, të Ligjit Për statusin, Komisioni kryen procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatëve për t’u pranuar në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës.

Në kuadër të këtij procesi, pas njoftimit të listës së kandidatëve me rezultatet më të larta nga Shkolla e magjistraturës, me propozim të Komisioni, Këshilli ka miratuar vendimet si më poshtë vijon:

- Vendim Nr.146, datë 07.06.2023 “Për fillimin e procedurave të verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatëve për t’u pranuar në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës në vitin akademik 2023-2024”.

- Vendim Nr.147, datë 07.06.2023 “Për hedhjen e shortit dhe caktimin e relatorit për verifikimin e pasurisë dhe figurës për kandidatët për t’u pranuar në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës në vitin akademik 2023-2024”.

Në zbatim të vendimeve të sipërcituara, Këshilli ka filluar procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës për 26 (njëzet e gjashtë) kandidatët për magjistratë, si dhe ka kërkuar informacion zyrtar nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkak tjetër përjashtues. Konkretisht, janë kërkuar informacione të detajuara nga ILDKPKI-ja, prokuroria, organet e administratës tatimore dhe doganore, shërbimet shtetërore informative, si dhe çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës të kandidatëve.

Komisioni ka kërkuar informacion shtesë nga institucionet përgjegjëse të sipërcituara, rast pas rasti për ndonjë nga kandidatët që u verifikuan.

Pas përfundimit të këtij procesi verifikimi, Këshilli mori vendim për të konsideruar të përfunduar verifikimin e pasurisë dhe figurës për 26 (njëzet e gjashtë) kandidatë për vitin akademik 2023-2024, sipas përcaktimeve të nenit 32, të Ligjit për Statusin.

c. Verifikimi i pasurisë dhe figurës për kandidatët për prokurorë të cilët përfunduan formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës në vitin 2023.

Mbështetur në pikën 1, të nenit 148/ç, në pikën 1, të nenit 149 dhe në germën “a”, të nenit 149/a të Kushtetutës, në pikën 1, të nenit 159 dhe pikën 2, të nenit 190, të Ligjit për Qeverisjen, në pikat 2-6, të nenit 32 dhe pikës 1, germa “c”, të nenit 35, të Ligjit për Statusin, si dhe në Rregulloren “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe për zhvillimin e karrierës së prokurorëve”, e ndryshuar, Komisioni kryen verifikimin e pasurisë, figurës dhe integritetit si dhe kushteve të tjera ligjore të kandidatëve për t’u emëruar magjistratë Prokuror, pas diplomimit në Shkollën e Magjistraturës.

Për vitin 2023 nga Shkolla e Magjistraturës ka pasur 26 (njëzetë e gjashtë) kandidatë të diplomuar në profilin Prokuror. Me propozim të Komisionit, Këshilli ka miratuar vendimet si më poshtë vijon:

- Vendim Nr.37, datë 07.02.2023 “Për fillimin e procedurave të verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatëve për magjistratë prokurorë, të cilët do të diplomohen nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2023”.
- Vendim Nr.38, datë 07.02.2023 “Hedhjen e shortit dhe caktimin e relatorit për verifikimin e pasurisë dhe figurës për kandidatët për magjistratë prokurorë, të cilët do të diplomohen nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2023”.

Mbështetur në nenin 32, të Ligjit për Statusin, Komisioni ka filluar procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës për 26 (njëzetë e gjashtë) kandidatët për magjistratë prokurorë, të cilët do të diplomohen nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2023. Në vijim të kësaj procedure, Komisioni ka kërkuar informacion zyrtar nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkak tjetër përjashtues. Konkretisht, janë kërkuar informacione të detajuara nga ILDKPKI, prokuroria, organet e administratës tatimore dhe doganore, shërbimet shtetërore informative, si dhe çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës të kandidatëve.

Në përfundim të këtij procesi është bërë verifikimi i plotë i pasurisë dhe figurës për secilin kandidat duke i hapur rrugë emërimit të tyre si magjistrat dhe caktimit në detyrë në prokuroritë përkatëse.

d. Verifikimi i pasurisë dhe figurës për kandidatët për pozicion drejtuesi në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm.

Mbështetur në nenin 47 dhe nenin 48, të Ligjit **për Statusin**, magjistrati mund të ngrihet në detyrë, në pozicionin e kryetarit të prokurorisë së shkallës së parë ose të dytë.

Vetëm kandidatët, të cilët kalojnë verifikimin e pasurisë dhe figurës dhe që nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranojnë në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë.

Gjatë vitit 2023 këshilli me propozim të Komisionit ka miratuar 7 (*shtatë*) vendime për verifikim pasurie dhe figure të kandidatëve për drejtues në prokuroritë e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, si më poshtë:

1. Vendimi Nr.6, datë 16.01.2023 *“Për verifikimin e pasurisë dhe figurës për prokuroren E. H, që ka kandiduar për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”*.
2. Vendimi Nr.7, datë 16.01.2023 *“Për verifikimin e pasurisë dhe figurës për prokurorin E. M, që ka kandiduar për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”*.
3. Vendimi Nr.8, datë 16.01.2023 *“Për verifikimin e pasurisë dhe figurës për prokurorin K. Ll, që ka kandiduar për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë”*.
4. Vendimi Nr.47, datë 23.02.2023 *“Për verifikimin e pasurisë dhe figurës për prokuroren E. H, që ka kandiduar për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”*.
5. Vendim Nr.48, datë 23.02.2023 *“Për verifikimin e pasurisë dhe figurës për prokuroren S. B, që ka kandiduar për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”*.
6. Vendim Nr.148, datë 16.06.2023 *“Për fillimin e procedurave të verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatët që kanë kandiduar për pozicion drejtuesi, të shpallur me vendimin Nr.139 datë 07.06.2023, të KLP-së.*
7. Vendim Nr.330, datë 20.10.2023 *“Për fillimin e procedurave të verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatin që ka kandiduar për riemërim në pozicionin e drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”*.

Komisioni pasi ka kryer të gjitha procedurat e parashikuara nga ligji, ka përfunduar vlerësimin e pasurisë dhe figurës për 6 (gjashtë) kandidatë. Ndërsa për një kandidat procedura është ende në proces.

15. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës pranë Këshillit ka pasur dhe këtë vit objektiv kryesor plotësimin e vendeve vakante në sistemin e prokurorisë me qëllim zbutjen dhe menaxhimin e pasojave të shkaktuara kryesisht nga procesi i rivlerësimit kalimtar të prokurorëve por edhe nga pamundësitë e përkohshme, mbushjes së moshës së pensionit apo kërkesave për dorëheqje. Sikurse dihet mekanizmat ligjorë për plotësimin e vakancave janë procedurat e emërimit dhe caktimit në detyrë të magistratëve të rinj, lëvizjes paralele, transferimit apo caktimit të përkohshëm, ngritjes në detyrë dhe përmes skemës së delegimit.

Referuar nenit 41, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të KLP-së”, fusha e veprimtarisë së Komisionit të Zhvillimit të Karrierës ka si objekt çdo çështje që kanë lidhje me:

- a) *procedurën e emërimit të kandidatëve për prokurorë, si dhe të caktimit të të emëruarve në pozicionet e lira ose caktimit të përkohshëm të tyre në pozicione të komanduara;*
- b) *procedurat e transferimit të prokurorëve;*
- c) *procedurën e caktimit të përkohshëm të prokurorëve;*
- ç) *procedurën e caktimit të prokurorëve në skemën e delegimit;*
- d) *procedurën e komandimit të prokurorit në një pozicion “joprokuror”, në një institucion brenda sistemit të drejtësisë;*
- dh) *procedurën e ngritjes në detyrë të prokurorëve;*
- e) *mbarimin e statusit të prokurorit;*
- ë) *trajtimin e kërkesave të prokurorëve, për ulje të ngarkesës së çështjeve;*
- e) *Hartimin dhe ndryshimin e akteve nënligjore, të cilat lidhen me fushën e veprimtarisë së Komisionit;*
- g) *të gjitha rastet e tjera të parashikuara me ligj, në përputhje me fushën e veprimtarisë së këtij Komisioni.*

Veprimtaria e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës ka qenë mjaft dinamike gjatë vitit 2023, edhe për shkak të fushës së veprimtarisë që mbulon, problematikave që dalin në vazhdimësi dhe nevojës për të dhënë zgjidhje optimale në kushtet kur sistemi përballlet me mungesa të konsiderueshme.

Për të pasur një panoramë sa më të plotë dhe të qartë, Komisioni, duke pasur parasysh edhe dinamikën e ndryshimit të përbërjes së zyrave të prokurorive për shkak të largimeve të shumta të prokurorëve, kryesisht për shkak të vettingut, ka krijuar dhe përditëson data bazën elektronike e cila përmban të dhënat në lidhje me

përbërjen e secilës prej zyrave të prokurorive, procedurat nëpërmjet të së cilave janë caktuar, emëruar apo transferuar prokurorët si dhe të dhëna të tjera statistikore, të cilat përditësohen në kohë reale.

Gjithashtu, kjo data bazë është plotësuar në mënyrë të vazhdueshme me të dhëna të tjera specifike që lidhen me datën e emërimit, me vjetërsinë në punë, moshën e magjistratëve, raportet gjinore etj, të cilat ndihmojnë në analizën rast pas rasti të lëvizjeve qoftë nëpërmjet caktimit të përkohshëm, komandimit, transferimit, lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë të prokurorëve.

Mbledhjet e Komisionit janë mbajtur periodike sa herë ka pasur çështje për diskutim dhe Relatorët e çështjeve janë caktuar me short mes anëtarëve të Komisionit ku për shkak se Kryetari i Komisionit është njëkohësisht edhe Kryetar i Këshillit, çështjet në këtë komision janë relatuar nga dy anëtarët e tjerë të këtij komisioni. Komisioni është asistuar në punën e tij edhe nga njësia përgjegjëse e këshilltarëve pranë komisioneve.

Gjatë vitit 2023, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, me miratimin e VKM-së Nr.495, datë 21.07.2022 “Për organizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”, është angazhuar në vlerësimin, analizën dhe propozimet përkatëse lidhur transferimet dhe/apo emërimet e prokurorëve.

Për periudhën 1 Janar 2023 – 31 Dhjetor 2023, Këshilli ka miratuar në seancë plenare në total 406 akte administrative me karakter individual, kolektiv ose normativ, prej të cilave 194 akte janë propozuar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Në aspektin sasior veprimtaria e këtij komisioni ka ndikuar në rreth 48 % të akteve të miratuara nga Këshilli.

Tabela sasiore e akteve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës

Lloj aktit	Sasia
Për caktim të përkohshëm.	37
Për ndërprerjen e caktimit të përkohshëm.	1
Për mbarim statusi për shkak dorëheqje, pensioni.	6
Për praktikën profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës.	1
Për transferim të përkohshëm me pëlqim.	3
Për përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit.	2
Për emërimin magjistratë.	26
Për caktimin në detyrën e prokurorit.	26

Për transferim të përhershëm pa pëlqim për efekt ristrukturimi.	1
Për shpalljen e vendeve vakante për procedurën e transferimit nëpërmjet LP në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm të shkollës së parë.	4
Për përcaktimin e numrit të kandidatëve për magjistratë profili prokuror në programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës.	1
Shpallje për komandim në Eurojust.	1
Për plotësimin komandimi në Eurojust.	1
Për komandim prokurori.	6
Shpallje për komandim pedagog pranë Shkollës së Magjistraturës.	1
Për shpalljen e vendeve vakante për drejtues të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.	2
Për shpalljen e vendit vakant për ngritje në detyrë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.	1
Për transferimin e përhershëm të prokurorëve nga prokuroritë pranë gjykatave të apelit, në prokurorinë pranë gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm, për efekt ristrukturimi.	1
Caktim nëpërmjet lëvizjes paralele.	28
Vendime të tjera.	45
Totali	194

Në rastin e caktimeve të përkohshme, Komisioni është treguar shumë i kujdesshëm në zbatimin e nenit 59, të Ligjit për Statusin duke e zbatuar këtë dispozitë vetëm në ato raste kur caktimi i përkohshëm i një prokurori në cilësinë e Drejtuesit, apo të prokurorit të juridiksionit të përgjithshëm apo në nivel apeli, ka qenë domosdoshmëri. Për rrjedhojë, Vendimet e Këshillit për caktimin e përkohshëm të prokurorëve kanë ardhur si rezultat i një vendimmarrje të organeve të rivlerësimit dhe krijimit të vendeve të lira përkohësisht për shkak të arsyeve të tjera të ndryshme.

Si rrjedhojë, nga 13 zyra të Prokurorive pranë Gjykatave të Shkallëve të Para, Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe Prokurorisë së Përgjithshme, në fund të vitit 2023 rezultojnë se:

- a) 4 prokurorë janë të caktuar përkohësisht si drejtues në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallëve të Para të Juridiksionit të Përgjithshëm. Kjo situatë pritet të ndryshojë pasi gjatë vitit 2023 është hapur procedura e plotësimit të pozicionit të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër dhe së shpejti pritet të përfundojë kjo procedurë. (aktualisht sot që është hartuar ky raport drejtuesi është emëruar) Gjithashtu, gjatë vitit 2024 do të hapen procedurat për plotësimin e vendeve vakante për Drejtues në tre Prokuroritë e tjera ku nuk ka patur kandidatë dhe në përfundim të këtyre procedurave pritet të mos ketë më caktime të përkohshme si Drejtues.
- b) 1 prokuror është caktuar përkohësisht nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës e Parë në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe 1 prokuror është caktuar përkohësisht nga Prokuroria e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Në vlerësim të të dhënave të mësipërme në këtë aspekt Komisioni, për rrjedhojë edhe KLP-ja ka përballuar mjaftueshëm mirë situatën sa i takon problematikave të shkaktuara nga vakancat e shumta në sistem, duke garantuar funksionalitetin e secilës zyrë prokurorie të sistemit.

Nga ana tjetër, për plotësimin në mënyrë permanente të vakancave të krijuara në sistem kanë shërbyer emërimet si magjistratë dhe caktimet në detyrë të 26 studentëve të diplomuar në vitin 2023, nga Shkolla e Magjistraturës. Vlen të theksohet se ky proces u realizua me dakordësinë e vetë studentëve pa qenë nevoja e konkurrimit apo përzgjedhjes së tyre nga ana e Këshillit.

Gjithashtu për nga rëndësia, duhet të evidentohet procedura administrative për plotësimin e 3 (tre) vakancave të fundit në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Proces si cili pas miratimit nga ana e Këshillit të renditjes së kandidatëve për prokurorë, vijon nga Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së këtyre Prokurorëve i cili funksionon pranë Prokurorisë së Posaçme.

Në funksion të këtij procesi me Vendimin Nr.303, datë 19.09.2023 Këshilli ka miratuar Rregulloren “*Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar*”. Me miratimin e kësaj rregullore u mundësua zhvillimi i një procesi plotësisht në përputhje me legjislacionin në fuqi, transparent dhe efektiv.

16. Komisioni i Disiplinor.

Objekti kryesor i punës së Komisionit Disiplinor është zhvillimi i procedurave disiplinore të filluara nga ILD-ja ndaj magjistratëve prokurorë në zyra apo nivele të ndryshme të sistemit të prokurorisë.

Komisioni Disiplinor, me administrimin e kërkesës për fillimin të procedimit disiplinor, të raportit të hetimit si dhe dosjes hetimore, të paraqitura nga ILD-ja fillon menjëherë procedurën disiplinore ndaj një magjistrati prokuror. Puna e këtij Komisioni është e ndërvarur me kërkesat për fillim të procedimit disiplinor të ILD-së.

a. Procedimet dhe hetimet disiplinore ndaj prokurorëve.

Objekti kryesor i punës së Komisionit Disiplinor është zhvillimi i procedurave disiplinore të filluara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë ndaj magjistratëve prokurorë në zyra apo nivele të ndryshme të sistemit të prokurorisë. Puna e këtij komisioni është e ndërvarur me kërkesat për fillim të procedimit disiplinor të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Gjatë vitit 2023, Komisioni Disiplinor ka zhvilluar 3 procedura disiplinore ndër të cilat 2 (*dy*) procedura disiplinore janë përfunduar me vendim shkarkimi nga detyra dhe 1 (*një*) procedurë është ende në proces.

Njëkohësisht gjatë vitit 2023, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka njoftuar KLP-në se ka filluar hetimin disiplinor për 3 (*tre*) magjistratë.

Zhvillimi i procedurave të mësipërme disiplinore ka konsoliduar më tej praktikën ekzistuese të këshillit, për sa i takon realizimit të procedurave disiplinore ndaj magjistratëve.

Në përputhje me përgjegjësitë e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore janë hartuar dhe administruar të gjitha aktet procedurale që përbëjnë procesin disiplinor që zhvillohet nga Këshilli.

Procedura disiplinore si një veprimtari quasi-gjyësore e Këshillit, përfshinë përgatitjen e procesverbaleve, relacioneve paraprake dhe përfundimtare, vendimeve, njoftimet dhe çdo korrespondencë tjetër zyrtare në funksion të procedurës disiplinore në ngarkim të prokurorëve për të cilët është paraqitur kërkesa për procedim disiplinor nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

b. Regjistri disiplinor.

Në përputhje me nenin 150, të Ligjit për Statusin dhe nenin 15, të Rregullores “*Mbi funksionimin e Komisionit Disiplinor në zhvillimin e procedurave disiplinore ndaj prokurorëve*”, KLP-ja ka përgatitur Regjistrin disiplinor.

Ky Regjistër i cili administrohet nga Komisioni Disiplinor, përmban të dhënat që kanë të bëjnë me: *çështjet në lidhje me procedimet disiplinore, si dhe vendimet e formës së prerë të marra në këto procedime, si dhe të gjithë ecurinë që i përket fazës së ekzekutimit të masave disiplinore.*

Në Regjistrin disiplinor janë pasqyruar të dhënat që i përkasin 2 (dy) procedimeve disiplinore të përfunduara gjatë vitit 2023, si dhe dinamika e veprimtarisë së Komisionit Disiplinor, në lidhje me këto procedura.

c. Aktivitete të tjera të Komisionit të Disiplinës.

Komisioni Disiplinor ka punuar për hartimin e një drafti të rregullores së përbashkët për bashkimin e procedimeve disiplinore mes KLP-së dhe KLGJ-së, në përputhje me nenin 140, të Ligjit për Statusin.

Për këtë qëllim, me mbështetjen e programit EU4JUSTICE, të Bashkimit Europian, janë zhvilluar takime me karakter teknik, në prani të anëtarëve të komisioneve disiplinore të dy këshillave dhe të përfaqësuesit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në të cilat janë diskutuar rregullimet e ndryshme por edhe vështirësitë duke patur parasysh specifikën që paraqet zhvillimi në praktikë i një procedure disiplinore për dy apo më shumë magjistratë (prokurorë dhe gjyqtarë) nga dy trupa të ndryshme administrative siç janë KLP-ja dhe KLGJ-ja.

Aktualisht, ekspertët e huaj të angazhuar nga EU4JUSTICE po punojnë për finalizimin e një drafti përfundimtar i cili do t'u përcillet paraprakisht për vlerësim komisioneve disiplinore.

KOMISIONET E TJERA.

17. Veprimtaria e Komisionit për mbrojtjen e prokurorëve.

Gjatë ushtrimit të funksionit ose për shkak të tij, magjistrati dhe familja e tij gëzojnë të drejtën të kenë mbrojtje të veçantë nga shteti për jetën, shëndetin dhe pasurinë e tyre. Në zbatim të këtij detyrimi ligjor është miratuar Vendimi Nr.564, datë 31.07.2019, "*Për kriteret dhe procedurat për mbrojtjen e veçantë të magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit ose për shkak të tij*", i Këshillit të Ministrave.

Sipas këtij vendimi, pranë Këshillit funksionon Komisioni për Mbrojtjen e Prokurorëve i cili shqyrton kërkesat për sigurimin e mbrojtjes së veçantë të prokurorëve. Gjatë vitit 2023, ky Komision ka shqyrtuar 14 (*katërmëdhjetë*) kërkesa për mbrojtje të veçantë apo për zgjatjen e afatit të mbrojtjes së veçantë ndër të cilat ka miratuar 13 (*trembëdhjetë*) prej tyre.

Me Vendimin Nr.403, datë 19.12.2023, “Për caktimin e anëtarit të Komisionit për Mbrojtjen e Prokurorëve”, Këshilli ka caktuar përfaqësuesin e tij në Komisionin për Mbrojtjen e Prokurorëve me një mandat dy vjeçar. Sipas VKM-së së cituar më sipër, përfaqësuesi i Këshillit është edhe kryetar i Komisionit për Mbrojtjen e Prokurorëve.

H. REZOLUTA E KUVENDIT, ZBATIMI DHE SFIDAT E KLP-SË PËR VITIN 2023.

18. Niveli i zbatimit të rezolutës së Kuvendit “Për raportin vjetor të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitin 2022”.

Kuvendi i Shqipërisë i rekomandon KLP-së për vitin 2023, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

- a. Të përmbyllë plotësimin e vakancave për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe të informojë Kuvendin brenda muajit dhjetor 2023.**

Me vendimin Nr.303, datë 19.09.2023, KLP-ja ka miratuar Rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar”.

Ndërsa me vendimin Nr.308, datë 29.09.2023, KLP-ja shpalli 3 vende vakante për ngritjen në detyrë të prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët, dokumentacioni që duhet të dorëzojnë dhe afatet e kandidimit u publikuan në faqen zyrtare ëeb të Këshillit, më datë 29.09.2023.

Gjithashtu, po në të njëjtën mbledhje plenare, me vendimin Nr.309, Këshilli caktoi me short dy anëtarët e Komisionit të Posaçëm për procedurën e plotësimit të këtyre vendeve vakante, konkretisht zotin Sokol Stojani nga radhët e prokurorëve, dhe zotin Tartar Bazaj nga radhët e joprokurorëve.

Në vijim të procesit, me vendimin Nr.322, datë 20.10.2023, Këshilli miratoi listën e kandidatëve për prokurorë pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar që plotësojnë kushtet ligjore, prej 8 kandidatësh, të cilët do të vijnë garën e mëtejshme.

Më tej, me vendimin Nr.372, datë 30.11.2023, KLP-ja vendosi miratimin e shkallës së vlerësimit të kandidatëve për ngritjen në detyrë në Prokurorinë e Posaçme dhe me vendimin Nr.387, datë 07.12.2023, miratoi renditjen e kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme, pasi dëgjoi edhe kandidatët, të cilët prezantuan platformën e tyre, si dhe iu përgjigjën pyetjeve të anëtarëve të KLP-së.

Në referim të rregullores për ngritje në detyrë në Prokurorinë e Posaçme, pas renditjes së kandidatëve, një komision ad hoc i ngritur pranë kësaj prokurorie do të kryejë verifikimin e pasurisë dhe figurës për kandidatët. Vetëm pas kalimit me sukses të verifikimit të pasurisë dhe figurës, KLP-ja do të mund të vijojë me emërimin si prokuror të SPAK të kandidatëve, përmes procedurës së ngritjes në detyrë.

Me përfundimin e kësaj procedure, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar do të përbëhet nga 20 prokurorë, duke përbushur kërkesat sipas vendimit Nr.6/2021, “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme”, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, ashtu sikurse edhe rekomandimin e Komisionit Evropian.

b. Të përmbyllë miratimin e akteve nënligjore sipas përcaktimeve në ligjet e reformës së drejtësisë dhe të raportojë në Kuvend për ecurinë brenda muajit dhjetor 2023.

Gjatë vitit 2023, KLP-ja ka miratuar aktet nënligjore si vijon:

1. Rregullorja “Për përcaktimin e rregullave dhe arsyeve të lejimit të kandidatit për magistrat për t’u emëruar në vitin pasardhës”;
2. Rregullorja “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë prokurorisë së posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar”;
3. Rregullorja “Për caktimin e rregullave dhe procedurave mbi uljen e ngarkesës së punës për prokurorët”;
4. Rregullorja “Mbi dhënien e lejes së papaguar”;
5. Rregullorja “Për vlerësimin etik dhe profesional të drejtuesve të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm”;
6. Rregullorja “Për caktimin e procedurës dhe masës së trajtimit financiar të prokurorit për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm, për caktimin e përkohshëm dhe caktimin për një çështje të veçantë”;
7. Rregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e administratës së KLP-së”.

Përveç sa më sipër, janë ngritur disa grupe pune, që po punojnë për hartimin e disa akteve të tjerë nënligjorë, që pritet të miratohen gjatë vitit 2024, si:

1. Rregullorja “Për kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e magistratëve në skemën e delegimit”;

2. Rregullorja “Për përmbajtjen e programeve të formimit vazhdues, shërbimet lehtësuese të lejuara, si dhe për procedurën e pajisjes me leje për ndjekjen e trajnimeve”;
3. Rregullorja "Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme”;
4. Rregullorja për "Përcaktimin e normës vjetore të ngarkesës në punë të prokurorëve”.
5. Rregullorja “Për procedurën e emërimit të Sekretarit të Përgjithshëm të Prokurorisë së Përgjithshme”;
6. Rregullorja “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të rekrutimit, të drejtave dhe detyrimeve, transferimit, pezullimit, disiplinës dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës të kancelarëve të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe këshilltarëve ligjorë jomagjistratë të Prokurorisë së Përgjithshme”;
7. Rregullorja "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit të sistemit të prokurorisë”;
8. Aktet nënligjore lidhur me statusin e nëpunësve civilë të prokurorisë sipas Ligjit Nr.97/2016, i ndryshuar;
9. Rregullore të përbashkëta me KLGJ-në:
 - Për bashkimin e procedimeve disiplinore;
 - Për caktimin e gjykatave, prokurorive dhe magjistratëve udhëheqës për programin e praktikës profesionale, vlerësimin etik, profesional si dhe cilësisë së kandidatëve magjistratë.

c. Të forcojë bashkëpunimin me Prokurorin e Përgjithshëm në funksion të realizimit të udhëzimeve me karakter të përgjithshëm nga prokurorët e të gjitha niveleve.

Gjatë vitit 2023, marrëdhëniet ndërmjet KLP-së dhe Prokurorisë së Përgjithshme kanë vijuar në drejtim të mbledhjes së informacionit të nevojshëm nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm të cilat janë domosdoshmëri në procesin e vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale të magjistratëve, prokurorë.

Në këtë procedurë është propozuar nga zyrat e prokurorisë dhe veçanërisht nga Prokurori i Përgjithshëm se, zgjidhja e problematikave të hasura do të minimizohej me përfshirjen e CAMS (sistemi i menaxhimit të dosjeve) me qëllim që informacioni statistikor lidhur me procesin e vlerësimit të orientohej drejt një saktësie më të lartë dhe kohe më të shkurtër. Në vijim kë bashkëpunim do të jetë në nivel teknik.

Në kuadër të procesit të vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale të drejtuesve të zyrave të prokurorive të juridiksionit të përgjithshme, në mënyrë të vazhdueshme ka vijuar konsultimi me Prokurorin e përgjithshëm për disa aspekte jetike të punës së tyre;

Përgjatë vitit 2023, bashkëpunimi është fokusuar në zbatimin e hartës së regjyqësore, e cila për pasojë solli mbylljen e disa zyrave të prokurorive të shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm si dhe të gjitha prokuroritë e apeleve të rretheve u bashkuan në një prokurori të vetme me seli në Tiranë.

Lidhur me miratimin e akteve normative është bashkëpunuar në mënyrë të vazhdueshme veçanërisht për çështjet të cilat ndikojnë apo ndërlidhen me fushën e përgjegjesisë së Prokurorit të Përgjithshëm;

Për sa i përket bashkëpunimit në funksion të realizimit të udhëzimeve me karakter të përgjithshëm nga prokurorët e të gjitha niveleve, theksojmë se KLP-ja ka asistuar Prokurorin e Përgjithshëm në kontribut sa herë që është kërkuar, duke qenë se kompetenca e plotë ligjore për vlerësim dhe vendimmarrje i takon këtij të fundit.

Në përfundim, informojmë se bashkëpunimi me Prokurorin e Përgjithshëm është konkretizuar me grup të përbashkët pune lidhur me aktin nënligjor:

- i. mbi përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve individuale për çdo nëpunës civil dhe punonjës të prokurorisë;
 - ii. Mbi kriteret dhe procedurat e rekrutimit të kancelarëve të zyrave të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe këshilltarëve ligjore jomagjistratë të Prokurorisë së Përgjithshme;
 - iii. Mbi procedurën e emërimit të Sekretarit të Përgjithshëm të Prokurorisë së Përgjithshme.
- d. Të përshpejtojë ritmet e punës në vlerësimin vjetor profesional të prokurorëve dhe të informojë Kuvendin brenda muajit tetor 2023.**

Sa i përket ecurisë së deritanishme të procesit të vlerësimit etik dhe profesional të prokurorëve, gjatë vitit 2023, Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, së bashku me Kryetarin e KLP-së, ka zhvilluar takime me drejtuesit e prokurorive dhe me grupet e punës që janë ngritur në funksion të procesit të vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim diskutimin e problematikave që po hasin në këtë proces dhe mbështetjen që ata kanë nevojë nga ana e KLP-së.

Nga diskutimet, rezultoi se ka vështirësi teknike në plotësimin e tabelave 1-14, të Aneksit Nr.2, të Rregullores “Për vlerësimin profesional dhe etik të prokurorëve”.

Aneksi Nr.2 i Rregullores ka miratuar modelin e tabelave statistikore me të dhënat për secilin prokuror që do të vlerësohet, si dhe të dhënat mesatare për seksionet apo të gjithë prokuroritë ku ka ushtruar detyrën prokurori i cili vlerësohet.

Plotësimi i tabelave statistikore të miratuara në Aneksin Nr.2, sipas përcaktimeve të ligjit Nr.96/2016, dhe Rregullores “*Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve*” ka hasur vështirësi teknike për shkak të integritetit të disa të dhënave referuese, të cilat nuk ishin parashikuar më parë në regjistrat fizikë dhe elektronikë që plotësonin prokuroritë për efekt statistikash. Plotësimi i një pjesë të dhënave statistikore në rrugë manuale ka sjellë vonesa në ecurinë e hedhjes së shortit të dosjeve që do të vlerësohen si pjesë e procesit të mëtejshëm.

Sa më sipër, u pa e nevojshme hartimi i një manuali orientues mbi plotësimin e tabelave të Aneksit Nr.2, të Rregullores “*Për vlerësimin profesional dhe etik të prokurorëve*”. Ky manual u përgatit nga ana e prokurorëve, të cilët janë komanduar në pozicionin e këshilltarit ligjor pranë KLP-së dhe i është dërguar elektronikisht drejtuesve të prokurorive, grupeve të punës dhe prokurorëve të shortuar. Manuali orientues është strukturuar në formën e shpjegimeve për secilën prej tabelave nga 1-14, të Aneksit Nr.2.

Nëpërmjet këtij manuali janë evidentuar dhe përshkruar të dhënat dhe treguesit statistikore që duhet të plotësohen nga zyrat e prokurorive dhe grupet përkatëse të punës sipas formularëve të miratuar më parë me Rregulloren “*Për vlerësimin profesional dhe etik të prokurorëve*” .

Në vijim, për t’i lehtësuar punën grupeve të punës, u pa gjithashtu e nevojshme të hartohet edhe një shtojcë, në mbështetje të këtij manuali, i cili sqaron në mënyrë grafike hedhjen e të dhënave në tabelat e Aneksit Nr.2, sipas formulave përkatëse.

Bazuar në nenin 171, pika 8 të ligjit Nr.96/2016, përcaktohet se: “*Të dhënat statistikore përpunohen nga gjykata ose prokuroria ku ushtron detyrën magjistrati që do të vlerësohet, si dhe dërgohen nga kryetari të Këshilli përkatës, deri në momentin që Këshillat kanë akses të drejtpërdrejtë në të dhënat e sakta dhe të sigurta statistikore në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve në gjykata dhe në prokurori. Të dhënat statistikore për magjistratin që është në proces vlerësimi i dërgohen Këshillit respektiv nga kryetari i gjykatës ose i prokurorisë, në të cilën magjistrati ka ushtruar detyrën gjatë periudhës për të cilën kryhet vlerësimi. Këshilli përcakton me vendim kohën dhe procedurat e marrjes drejtpërdrejt të të dhënave statistikore nga sistemi*”. Për këtë, një rrugëzgjdhje e domosdoshme dhe e menjëhershme është krijimi i një programi statistikor për sistemin e prokurorisë, të ngjashëm me atë që sistemi gjyqësor ka aktualisht.

Pas zgjidhjes së problematikave të sipërcituara, ka përfunduar plotësimi i të gjitha tabelave që i përkasin Aneksit Nr.2 dhe ka përfunduar shortimi i dosjeve për të gjithë prokurorët. Këshilli ka filluar me hartimin e raporteve analitike të vlerësimit

etik dhe profesional nga ana e prokurorëve të komanduar dhe relatorëve përkatës dhe gjatë vitit 2024 priten raportet e para.

Sa i përket bashkëpunimit me Prokurorin e Përgjithshëm, për procesin e vlerësimit etik dhe profesional të prokurorëve, në takimet e zhvilluara me të, është trajtuar problematika e hasur dhe nevoja e bashkëpunimit në plotësimin e regjistrave fizikë statistikorë me të dhënat që kërkohen për procesin e vlerësimit etiko-profesional të prokurorëve, si dhe nevojën e krijimit të një sistemi të unifikuar elektronik të të dhënave statistikore.

- e. Në bashkëpunim me KLGJ-në: i. të miratohen rregullat e përbashkëta për bashkimin e procedimeve në rastin kur një gjyqtar dhe një prokuror janë përfshirë në të njëjtën shkelje, si dhe ii. për ngritjen e një sistemi të ri për menaxhimin e integruar të çështjeve.**

Mbi këtë rekomandim puna ka vijuar me krijimin zyrtar të grupit të përbashkët të punës dhe realizimin e disa mbledhjeve të përbashkëta ku janë evidentuar disa problematika të çështjes. Nisur nga ky fakt, është konstatuar nevoja e asistencës nga misionet ndihmëse. Konkretisht EU4JUSTICE ka përgatitur një draft i cili është në fazë vlerësimi dhe diskutimi nga të dy Këshillat.

- f. Të ndjekë dhe të konsiderojë me përparësi angazhimet, detyrimet ligjore dhe funksionale që burojnë nga procesi i zbatimit të hartës gjyqësore.**

Sa i përket zbatimit të hartës së re gjyqësore, pas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.495, datë 21.07.2022, “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave gjyqësore të gjykatave”, KLGJ-ja, me Vendimet Nr.129, 130, 131, 132, 133, 134, 135, 136, 137, 138, 139, 140 dhe 141 datë 28.03.2022, për fillimin e funksionimit të Gjykatave të së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, përkatësisht Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë, Kukës, Shkodër, Tiranë, Berat, Elbasan, Sarandë dhe Vlorë, filloi ristrukturimin e Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, duke i grupuar ato në 13 gjykata. Gjykatat që u shkrinë, janë Gjykatat e Shkallës së Parë Mat, Kavajë, Lushnjë, Përmet, Kurbin, Pogradec, Tropojë, Pukë dhe Krujë.

Prokurori i Përgjithshëm, brenda kompetencave që i jep legjislacioni në fuqi, me Urdhrin Nr.54, datë 18.04.2023 “Për caktimin e strukturës organike të prokurorive pranë Gjykatave të Shkallëve të Para dhe Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm” përcaktoi ndarjen dhe numrin e prokurorëve në prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallëve të Para dhe asaj të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

KLP-ja, referuar sa më sipër, filloi procesin e ristrukturimit të prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm duke i organizuar ato në 13 prokurori.

Sa më sipër:

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor **Berat**, emërtohet Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor **Dibër**, emërtohet Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër. Prokuroria që u riorganizua në kuadër të procesit të sipërpërmendur është ajo pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, e cila u përthith nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, e cila bazuar në Urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm quhet Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor **Elbasan**, emërtohet Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor **Fier**, emërtohet Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm. Prokuroria që u riorganizua në kuadër të procesit të sipër përmendur është ajo pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, e cila u përthith nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, e cila bazuar në Urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm quhet Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor **Gjirokastër**, emërtohet Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm. Prokuroria që u riorganizua në kuadër të procesit të sipër përmendur është ajo pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, e cila u përthith nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, e cila bazuar në Urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm quhet Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor **Lezhë**, emërtohet Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm. Prokuroria që u riorganizua në kuadër të procesit të sipër përmendur është ajo pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, e cila u përthith nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, e cila bazuar në Urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm quhet Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor **Korçë**, emërtohet Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm. Prokuroria që u riorganizua në kuadër të procesit të sipër përmendur është ajo pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, e cila u përthith nga Prokuroria pranë Gjykatës së

Rrethit Gjyqësor Korçë e cila bazuar në Urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm quhet Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor **Kukës**, emërtohet Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm. Prokuroria që u riorganizua në kuadër të procesit të sipër përmendur është ajo pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, e cila u përthith nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, e cila bazuar në Urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm quhet Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor **Sarandë**, emërtohet Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor **Shkodër**, emërtohet Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm. Prokuroria që u riorganizua në kuadër të procesit të sipër përmendur është ajo pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, e cila u përthith nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër e cila bazuar në Urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm quhet Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor **Tiranë**, emërtohet Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm. Prokuroria që u riorganizua në kuadër të procesit të sipër përmendur është ajo pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, e cila u përthith nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila bazuar në Urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm quhet Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor **Vlorë**, emërtohet Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor **Durrës**, emërtohet Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm. Prokuroria që u riorganizua në kuadër të procesit të sipër përmendur është ajo pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, e cila u përthith nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila bazuar në Urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm quhet Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Sa i përket Prokurorive pranë Gjykatave të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, KLGJ-ja, me Vendimin Nr.505, datë 21.11.2022, “*Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm*”, ka filluar ristrukturimin e Gjykatave të Apelit, duke i grupuar ato në një të vetme të quajtur

Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm. Gjykata e Apelit Tiranë emërtohet Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm. Gjykatat u shkrinë janë Gjykatat e Apelit Durrës, Gjirokastër, Korçë, Shkodër dhe Vlorë.

Prokurori i Përgjithshëm, brenda kompetencave që i jep legjislacioni në fuqi, me Urdhrin Nr.9, datë 18.01.2023 *“Për caktimin e strukturës organike të prokurorive pranë Gjykatave të Shkallëve të Para dhe Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”* përcaktoi ndarjen dhe numrin e prokurorëve në prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallëve të Para dhe asaj të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

KLP-ja, referuar sa më sipër, filloi procesin e ristrukturimit të prokurorive pranë Gjykatave të Apelit duke i riorganizuar ato në një të vetme, Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, emërtohet Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (me seli në Tiranë). Prokuroritë që u riorganizuan në kuadër të procesit të sipërpërmendur janë ato pranë Gjykatave të Apelit Durrës, Gjirokastër, Korçë, Shkodër dhe Vlorë, të cilat u përthithen nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila bazuar në Urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm do të quhet Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Në vijim të këtij procesi, KLP-ja, me vendimin Nr.22, datë 30.01.2023, vendosi që:

Prokurorët e emëruar/caktuar (në mënyrë të përhershme) në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë qëndrojnë në pozicion në strukturën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Prokurorët e emëruar/caktuar (në mënyrë të përhershme) në Prokuroritë pranë Gjykatave të Apelit Durrës, Gjirokastër, Korçë, Shkodër dhe Vlorë, të cilëve iu suprimohet pozicioni për shkak të riorganizimit gjyqësor, transferohen prokurorë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Sa më sipër, KLP-ja ka përmbushur të gjitha detyrimet ligjore që i takojnë për zbatimin me efektivitet dhe eficiencë të hartës së re gjyqësore.

- g. Të bashkëpunojë me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për hartimin e planit vjetor të inspektimeve tematike, në përputhje me përcaktimet e ligjit Nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, veçanërisht në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut, barazisë para ligjit dhe parimit të proporcionalitetit në proceset penale.**

Gjatë veprimtarisë së Këshillit që merr shkas nga procedimet disiplinore është konstatuar si problematikë çështja e lirimit para kohe me kusht dhe përfitimit të uljes së padrejtë të dënimit. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka zhvilluar një

inspektim tematik i cili është përfunduar së fundmi dhe ka adresuar problematikat dhe shqetësimet e vetë Këshillit.

h. Të adresojë çështjet e konstatuara lidhur me aktivitetin e Këshillit në progresraportin e Bashkimit Evropian të vitit 2022.

Sa i përket çështjeve të konstatuara lidhur me aktivitetin e KLP-së në progresraportin e BE, informacioni gjendet plotësisht i raportuar në Kapitullin “Marrëdhëniet ndërinstitucionale dhe integrimi evropian”.

I. KONKLUZIONE TË NXJERRA NGA VEPRIMTARIA E VITIT 2023, SFIDAT DHE PRIORITETET PËR VITIN 2024.

19. Konkluzione të nxjerra nga veprimtaria e vitit 2023.

KLP-ja, gjatë vitit 2023, ka marrë gjithsej 406 vendime, i mbledhur gjithsej në 32 mbledhje plenare të zhvilluara. Vendimmarrja ka qenë kryesisht e lidhur me akte administrative individuale në funksion të karrierës së prokurorëve.

KLP-ja gjatë vitit 2023 ka hartuar dhe miratuar tetë akte nënligjorë, të cilët janë tepër të rëndësishëm dhe në funksion të karrierës së prokurorëve, si: Rregullorja “Për përcaktimin e rregullave dhe arsyeve të lejimit të kandidatit për magjistrat për t’u emëruar në vitin pasardhës”; Rregullorja “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë prokurorisë së posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar”; Rregullorja “Për caktimin e rregullave dhe procedurave mbi uljen e ngarkesës së punës për prokurorët”; Rregullorja “Mbi dhënien e lejes së papaguar”; Rregullore “Për vlerësimin etik dhe profesional të drejtuesve të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm”; Rregullore “Për caktimin e procedurës dhe masës së trajtimit financiar të prokurorit për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm, për caktimin e përkohshëm dhe caktimin për një çështje të veçantë”; Rregullore “Për organizimin dhe funksionimin e administratës së KLP-së”.

Gjatë vitit 2023, në kuadër të procedurës së ngritjes në detyrë të drejtuesve të zyrave të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, ka përfunduar procedura për ngritje në detyrë për 2 (dy) prokuror. Është në proces edhe 1 (një) procedurë për ngritje në detyrë në pozicion drejtuesi dhe 2 (një) procedura për transferim nëpërmjet lëvizjes paralele.

Lidhur me ngritjen në detyrë në pozicionin e prokurorit në Prokurorinë e Posaçme, nga ana e Këshillit janë përfunduar të gjitha procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve për plotësimin e 3 vakancave të fundit të kësaj strukture. Duke pasur

parasysh rëndësinë e veçantë të kësaj strukture dhe pritshmërinë e lartë të opinionit publik konsiderohet si një arritje e veçantë e veprimtarisë së Këshillit për këtë vit.

Gjatë vitit 2024 pritet që të kemi një përmirësim të situatës së vakancave në sistem duke qenë se në muajin Qershor pritet të përfundojë procesi i rivlerësimit kalimtar në KPK dhe numri i prokurorëve që ende nuk kanë kaluar këtë proces është 33 prokurorë. Gjithashtu, në vitin akademik 2023-2024 pritet të diplomohen dhe të emërohen Magjistrat Prokuror edhe njëzet e tre studentë të Shkollës së Magjistraturës, të cilët do ndihmojnë ndjeshëm në funksionimin normal të prokurorive.

Stabilizimi i situatës së vakancave në sistem do ti japë mundësi Këshillit për t'u fokusuar më tepër gjatë vitit 2024 në realizimin e politikave që synojnë promovimin e prokurorëve me qëllim rritjen e cilësisë dhe performancës së punës së secilit prokuror dhe për rrjedhojë të çdo zyre prokurorie.

Sa i takon procesit të llogaridhënies së prokurorëve, KLP-ja ka konsoliduar më tej praktikën e tij në këtë drejtim, duke trajtuar me efektivitet dhe brenda afateve ligjore të gjitha çështjet e paraqitura për trajtim nga ILD-ja.

Për periudhën në vazhdim, një prej komponentëve themelorë të veprimtarisë së KLP-së, i cili është në fokusin aktual të punës së tij, është procesi i vlerësimit etiko-profesional të prokurorëve. KLP-ja ka miratuar Rregulloren për Vlerësimin Etik dhe Profesional të Prokurorëve; Programin që përcakton listën e prokurorëve, për të cilët do të kryhet vlerësimi përgjatë vitit 2023; Planin tre-mujor të vlerësimit; dhe ka caktuar me short relatorët dhe këshilltarët ligjorë përgjegjës për procedurën e vlerësimit të prokurorëve.

20. Sfidat dhe Prioritetet e punës së KLP-së për vitin 2024.

Sikurse edhe vitin e kaluar, sfida kryesore mbetet plotësimi i vakancave deri në përfundim të procesit të rivlerësimit, për të garantuar funksionimin normal dhe efektshmërinë e veprimtarisë së prokurorive. Edhe pse roli i KLP-së në këtë drejtim është dytësor, sikurse e përmendëm më sipër, jemi përpjekur për të adresuar këtë problematikë nëpërmjet mekanizmave të transferimit apo caktimeve të përkohshme.

Me gjithë arritjet e pasqyruara në këtë raport, Këshilli mbetet i fokusuar në punën e tij në drejtim të realizimit të vlerësimeve të prokurorëve, nëpërmjet një procesi të drejtë dhe objektiv. Kjo do të realizohet nëpërmjet plotësimit të kuadrit ligjor të vlerësimit me aktet e tjera nënligjore që janë në proces për t'u miratuar në funksion të veprimtarisë së vlerësimit dhe krijimi i një sistemi kompjuterik, për të mundësuar gjenerimin e të dhënave statistikore të domosdoshme për vlerësimet periodike të prokurorëve.

Duke qenë të ndërgjegjshëm për vështirësitë e këtij, vlerësojmë se gjatë vitit 2024 ky proces do të zhvillohet me ritme të shpejta, pasi ka përfunduar pjesa më e madhe e proceseve paraprake, si dhe për shkak të eksperiencës së fituar gjatë vitit 2023, që do të mundësojnë hartimin e akteve përfundimtare për këtë qëllim.

Gjithashtu, vëmendje të veçantë do të ketë realizimi i objektivave të përealizuara të Planit Strategjik aktual, përgatitja dhe hartimi i planit të ri strategjik për 4 vitet në vazhdim, plotësimi i diferencave buxhetore në zërat e buxhetit që lidhen me pagat dhe sigurimet shoqërore për shkak të efekteve të pritshme që rrjedhin nga zbatimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.35, datë 22.11.2022 si dhe miratimi i akteve nënligjore.

Fuqizimi i bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës, Prokurorin e Përgjithshëm, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, si dhe çdo institucion tjetër, në funksion të realizimit të objektivave të Këshillit, mbetet një prioritet i rëndësishëm për të ardhmen.

Në aspektin infrastrukturor, një synim i KLP-së për vitin 2024 është digjitalizimi e arkivave të sistemit të tij dhe të sistemit të prokurorisë në tërësi me qëllim rritjen e kapaciteteve përpunuese dhe përdorimit të teknologjisë në tërësi, për të rritur produktivitetin, sigurinë, besueshmërinë dhe efikasitetin e punës.

Së fundi KLP-ja, shpreh bindjen se viti 2024, do të shënojë përmbushjen e të gjitha objektivave të përcaktuara si në Planit Strategjik 2021-2024 të KLP-së, ashtu edhe në Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.